

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5861
E hënë, 26 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Në Kleçkë zbulohet busti i komandant 'Kumanovës'

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BAJRAM HASANI ■ FAQE 4 - 5

Haradinaj e fuqizoi shtetin e Kosovës

Anëtari i kryesisë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Bajram Hasani, ka thënë se është e dukshme rritja e kësaj partie në Anamoravë dhe në tërë Kosovën. Ai beson se në këto zgjedhje qytetarët e këtij rajoni do ta mbështesin Aleancën dhe bashkë do ta mundësojnë zhvillimin e Anamoravës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hasani ka thënë se AAK-PSD është koalicioni i fitores. Pritjet për këtë fitore ai i bazon në qeverisjen e mirë të kryeministrit Ramush Haradinaj. Ai ka vlerësuar se Qeveria Haradinaj ka vendosur baza të rëndësishme për fuqizimin e shtetit të Kosovës. Hasani ka thënë se kryeministri ka vendosur një standard të ri në politikëbërje në Kosovë duke ndërmarrë veprime që treguan se ky vend ka zot shtëpie. Në këtë intervistë ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë është shprehur i gatshëm të jetë pjesë e listës së AAK-së për deputet



LDK-ja sot pritet ta zyrtarizojë kandidatin për kryeministër

FAQE 3

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sot (e hënë) pritet ta caktojë kandidatin për kryeministër për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Anëtari i Kryesisë së LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se debati për këtë çështje do të mbyllet të hënë. Ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV), koalicioni AAK-PSD dhe koalicioni Nisma-AKR kanë zyrtarizuar liderët e tyre kandidatë për kryeministër



Pacolli kërkon nga BE-ja të veprojë pas sulmit të autobusit në Serbi

FAQE 3

OPINION

QAZIM ZEKAJ
BIRI I
LAVDISHËM
I PODGURIT F. 13



Ismet SYLEJMANI

AKTUALE

KANDIDATËT DEMOKRATË
PËR PRESIDENT PËRPIQEN
TË KUALIFIKOHEN PËR
DEBATIN E RADHËS F. 2

HARADINAJ NË DEÇAN:
ALEATËT NA LANË HAPËSIRË
PËR VENDIME TË MËDHA F. 6

EKONOMI

AUVK-U ASGJËSOI MBI 300
MIJË KILOGRAMË PRODUKTE
USHQIMORE GJATË KËTIJ VITI F. 9

ASISTENCA SOCIALE PËR 25
MIJË FAMILJE, E MJAFTUESHME
VETËM PËR TË MBIJETUAR F. 9



KULTURË

VESELI: RUAJTJA, KULTIVIMI
DHE PROMOVIMI I
TRASHËGIMISË KULTURORE,
PRIORITETE TONA F. 3

SPORT

KOSOVA LA GJURMË
NË EVROPIAN F. 20

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Erdogani planifikon ta takojë Putinin në Moskë në fund të muajit

ANKARA, 25 GUSHT - Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan, planifikon të udhëtojë në Moskë nesër (e martë), për ta takuar presidentin rus, Vladimir Putin. Zyra e presidentit Erdogan ka njoftuar se takimi është vendosur pas një telefonate në mes të

dy presidentëve, ku u diskutua për zhvillimet në Siri. Kremlini zyrtar theksoi se Putini dhe Erdogani janë pajtuar gjatë bisedës për të shtuar përpjekjet që të qetësohet situata në provincën Idlib, ku dhuna ka detyruar dhjetëra mijëra per-

sona të ikin nga vendi. Turqia deri më tash ka pranuar më shumë se 3,6 milionë refugjatë nga Siria që nga konflikti në mars të vitit 2011. Që nga fundi i muajit prill, Qeveria e Sirisë dhe Ushtria e Rusisë kanë bombarduar

provincën Idlib - bastionin e fundit të forcave që kundërshtojnë regjimin e Asadit. Rusia dhe Turqia mbështesin palë të ndryshme në këtë konflikt. Rusia kishte ndihmuar pas lansimit të fushatës ajrore ndaj



presidentit sirian si dhe kishte rritur prezencën ushtarake në Siri më 2015.

Kandidatët demokratë për president përpigjen të kualifikohen për debatin e radhës

Numri i madh i kandidatëve demokratë ka filluar ngadalë të tkurret me daljen nga gara të guvernatorit të shtetit të Uashingtonit, Jay Inslee dhe ish-guvernatorit të Kolorados, John Hickenlooper, i cili tani po kandidon për në Senat



UASHINGTON, 25 GUSHT - Kandidati demokrat për president Julian Castro mori një lajm të mirë këtë javë. Ai u bë demokrati i 10-të që u kualifikua për të marrë pjesë në debatin presidencial demokrat të muajit të ardhshëm në Houston, Texas. Por disa demokratë të tjerë ka shumë gjasa të mos përfshihen në debatin e radhës, gjë që do t'i dëmtojë shanset e tyre për të siguruar mbështetje në betejën presidenciale me shumë kandidatë dhe shpesh kaotike brenda partisë.

Për Julian Castron, një periudhë aktivitet intensiv fushate ka sjellë rezultat, duke siguruar përfshirjen në raundin e tretë të debateve demokrate muajin e ardhshëm, ka raportuar "VOA". "Besoj se mund të bëhem edhe më të fortë. Kemi edhe pesë muaj deri në zgjedhjet paraprake në Iowa dhe New Hampshire. Dhe deri atëherë, nëse punojmë intensivisht, unë mund të bëhem kandidati kryesor", ka thënë Castro.

Por, nuk ka qenë njëloj për kryetarin e bashkisë së Nju

Jorkut, Bill de Blasio, i cili po has vështirësi të kualifikohet për debatin e radhës.

"Është një objektivi i vështirë për ne. Kemi punuar në këtë drejtim dhe mënyra si e shoh unë është që nëse nuk hyjmë në debatin e shtatorit, të mund të përfshihemi në tetor", ka deklaruar de Blasio.

Numri i madh i kandidatëve demokratë ka filluar ngadalë të tkurret me daljen nga gara të guvernatorit të shtetit të Uashingtonit, Jay Inslee dhe ish-guvernatorit të Kolorados, John Hickenlooper, i cili tani po kandidon për në Senat. "Por kjo nuk është koha për t'u larguar nga tryeza. E di që është e vështirë të ndryshohet Uashingtoni, por dua ta provoj", ka thënë Hickenlooper.

Demokratët e tjerë ende po e vazhdojnë garën, pavarësisht shifrave të ulëta në sondazhe, përfshirë senatorin e New Jersey-t, Cory Booker. "Dhe të qëndrojmë së bashku dhe punojmë së bashku, të duam së bashku dhe ta kapërcejmë errësirën e tij me dritën tonë! Kjo është thirrja e vendit tonë

dhe është koha që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të ngrihen përsëri! Faleminderit!", ka pohuar Booker.

Senatori Booker do të jetë në debatin e radhës, ashtu si dhe senatorja nga Minesota, Amy Klobuchar. "Kam në plan ta vazhdoj ta sfidoj Donald Trumpin. Do të vazhdoj të argumentoj për një program optimist ekonomik për vendin", ka thënë Klobuchar. Por për ata që nuk arrijnë të kualifikohen për debatin tjetër, rruga e fushatës veçse bëhet më e vështirë, thotë analistja Susan Page. "Kemi serinë e tretë të debateve në fillim të

shtatorit dhe kualifikimi për ato debate është i vështirë. Mendojmë se numri i tyre do të zvogëlohet. Dhe kur një kandidat nuk hyn në debat, bëhet më e vështirë të grumbullojë para për të siguruar mbështetje për të qëndruar në garë", ka deklaruar ajo.

Por, me mbi 20 kandidatë për president, muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë për disa nga kandidatët që nuk kanë siguruar shumë mbështetje, thotë analisti Darrell West. "Mendoj se një numër kandidatësh do të dalin nga gara brenda një ose dy muajve të ardhshëm. Me siguri ata që

nuk kualifikohen për debatet e ardhshme në shtator, do të shohin që fondet e tyre do të tkurren dhe ata që do të humbasin platformën e medieeve. Kështu që kandidaturat e tyre në thelb do të marrin fund", ka theksuar ai.

Ish-nënpresidenti Joe Biden vazhdon të udhëheqë mes kandidatëve demokratë, pasuar nga senatorja nga Masaçusets Elizabeth Warren, senatori nga Vermonti Bernie Sanders, senatorja nga Kalifornia Kamala Harris dhe kryetari i Bashkisë i qytetit South Bend të Indianës, Pete Buttigieg.

Tusk: BE-ja e gatshme të dëgjojë idetë e Boris Johnson për Brexit-in

BRUKSEL, 25 GUSHT - Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, tha se Bashkimi Evropian ka shprehur vullnetin të dëgjojë idetë e kryeministrit britanik, Boris Johnson për Brexit-in, nëse ato janë "realiste".

Por, duke folur në një konferencë të Samitit G7, Tusk tha se nuk do të bashkëpunojë për Brexit pa marrëveshje.

Tusk dhe Johnson pritet të takohen të dielën për të diskutuar Brexit-in.

Që kur mori mandatin, Johnson ka insistuar se Britania do të largohet nga BE-ja më 31 tetor.

Tusk kishte thënë se Johnson është kryeministri i tretë që i duhet ta takojë që kur Britania votoi ta dalë nga BE-ja më 2016.

"Ne jemi të gatshëm të dëgjojmë ide që janë funksionale, realiste dhe të pranueshme për të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Shpresoj se kryeministri Johnson nuk do të mbes në histori si 'Zotëri pa mar-

rëveshje".

Kryeministri Johnson dëshiron të rinegociojë Irlandën, një pikë kyçe e marrëveshjes së Brexit-it që ka për qëllim të parandalojë një kufi të mundshëm në ishullin e Irlandës pas Brexit-it.

Kryeministri britanik, Boris Johnson më herët i ka thënë Bashkimit Evropian se plani për të krijuar ndalesë në kufirin irlandez, duhet të pezullohet, pasi është "i paarritshëm" dhe "jodemokratik".



Partitë politike zyrtarizojnë kandidaturat për kryeministër

LDK-ja sot pritet ta zyrtarizojë kandidatin për kryeministër

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sot (e hënë) pritet ta caktojë kandidatin për kryeministër për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Anëtari i Kryesisë së LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se debati për këtë çështje do të mbyllet të hënë. Ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV), koalicioni AAK-PSD dhe koalicioni Nisma-AKR kanë zyrtarizuar liderët e tyre kandidatë për kryeministër

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 GUSHT - Në zgjedhjet e parakohshme që pritet të mbahen së shpejti, postin e kryeministrit pritet ta kërkojnë pesë liderë politikë, kurse Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV), koalicioni AAK-PSD dhe koalicioni Nisma-AKR kanë dominuar kandidatët për kryeministër, por Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk e ka bërë një gjë të tillë. Kjo parti në mbledhjen e parë të kryesisë së re e ka hapur debatin për këtë çështje, por nuk ka arritur të nxjerrë një emër për këtë post.

Zyrtarët e kësaj partie kanë bërë me dije se kjo çështje do të mbyllet sot (e hënë), ku do të mbahet sërish mbledhja e Kryesisë së LDK-së. "Në mbledhjen e parë të kryesisë së re të LDK-së u pajtuam se nuk do të kemi koalicion me PDK-në në asnjë situatë; në mbledhjen e radhës të Këshillit të Përgjithshëm do të diskutohet për koalicionin e mundshëm me Vetëvendosjen. Posti i kryeministrit i takon partisë më të madhe, LDK-së, e diskutimet për mandatarin e LDK-së do të mbyllen të hënë", ka thënë Avdullah Hoti. Edhe zëdhënësi i LDK-së, Besian

Mustafa, ka treguar se për këtë çështje do të diskutohen në mbledhjen e radhës të Kryesisë së LDK-së. "Në takimin e ardhës të Kryesisë, i cili do të mbahet të hënë në mëngjes, do të diskutohet edhe për mandatarin e LDK-së për kryeministër të ardhshëm", ka thënë Mustafa.

Në mbledhjen e së shtunës ishte paralajmëruar se kandidatë e LDK-së për kryeministër mund të dalë Vjosa Osmani. Mediet kanë raportuar se Osmani kishte marrë përkrahjen e liderit të LDK-së, Isa Mustafa, e cila ishte kundërshtuar nga dy figura të rëndësishme të LDK-së, ish-nënkryetarët e kësaj partie, Lufti Haziri dhe Agim Veliu, të cilët nuk kishin marrë pjesë fare në këtë mbledhje.

Për dallim prej LDK-së, oponentët politikë të kësaj partie tashmë kanë dalë me kandidatët e tyre për postin e kryeministrit në zgjedhjet e ardhshme.

Këshilli Drejtues i PDK-së të premten ka zyrtarizuar liderin e kësaj partie, Kadri Veseli, për kryeministër. Nënkyetari i PDK-së, Hajredin Kuçi, në një konferencë për media pas përfundimit të mbledhjes së Këshillit Drejtues të PDK-së, ka thënë se Kadri Veseli është personaliteti i dëshmuar, një nga themeluesit e UÇK-së, një njeri që ishte i gatshëm ta sakrifikoje jetën për lirinë dhe

pavarësinë e Kosovës dhe sot u prin përpjekjeve konkrete për një të ardhme më të mirë për vendin tonë, për qytetarët tanë. "Ne zgjedhëm një njeri që jep shpresë për ta ndërtuar një të ardhme këtu. Zgjedhëm njeriun që mund ta udhëheqë një luftë të pakompromis kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Kadri Veseli tashmë ka vepruar kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Ai ka bërë reforma të guximshme, duke nisur nga brenda PDK-së. Sepse, për ta ndryshuar vendin duhet që ndryshimin ta fillojmë nga vetvetja. Ne e kuptojmë se janë bërë

gabime në të kaluarën. E kuptojmë që kjo ka bërë që shumë qytetarë ta humbin besimin në politikë. Sidoqoftë, mos harroni, politika e gabuar ka shkaktuar probleme, por politika e duhur është mënyra e vetme për t'i zgjidhur ato", ka thënë Kuçi. Po të premten, pasi është nënshkruar koalicioni parazgjedhor Nisma-AKR, është bërë me dije se kandidat për kryeministër i këtij koalicioni do të jetë Fatmir Limaj, lideri i Nismës Socialdemokrate. "Sot kemi marrë dy partitë politike, që është një bosht e pritët t'i bashkohen edhe parti të tjera.

Besoje se koalicioni parazgjedhor e jep një mundësi të re. E unë po njoftoj se do të jem kandidat i këtij koalicioni për kryeministër", ka thënë Limaj.

Edhe koalicioni AAK-PSD ditën e nënshkrimit ka bërë me dije se kandidat për kryeministër i këtij koalicioni do të jetë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ndërsa në Lëvizjen Vetëvendosje prej kohësh kanë bërë me dije se Albin Kurti do të jetë kandidat për kryeministër. Madje, zyrtarët e lartë të kësaj partie kanë bërë me dije se për këtë post nuk bëjnë kompromis me asnjë parti.

Veseli: Ruajtja, kultivimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, prioritete tona



PRISHTINË, 25 GUSHT (ER) - Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të dielën ka promovuar trashëgiminë kulturore, duke thënë se edhe puna artizanale sjell të ardhura. Veseli ka vizituar organizatën "Dita", përfituese e granteve të Ministrisë së Kulturës, ku rreth 50 gra dhe vajza prodhojnë veshje tradicionale. Ai ka thënë se nga lufta kundër korrupsionit dhe keqpërdorimeve janë kursyer fonde që kanë mundësuar mbështetjen e kësaj organizatë, e cila tani jep kontribut të dyfishtë për të mirën e shoqërisë. "Ruajtja, kultivimi

dhe promovimi i trashëgimisë sonë të pasur kulturore është prioritet për ne. Në organizatën 'Dita', përfituese e granteve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, puna artizanale asnjëherë nuk ndalet. Rreth 50 vajza e gra janë të trajnuara dhe angazhuara për të prodhuar veshje tradicionale, duke siguruar kështu të ardhura nga një segment i veçantë që plotëson nevojat e shoqërisë sonë. Nga lufta kundër korrupsionit dhe keqpërdorimeve janë kursyer fonde që kanë mundësuar mbështetjen e kësaj organizatë, e cila tani jep kontribut të

dyfishtë për të mirën e shoqërisë. Kjo trashëgimi e çmuar e popullit tonë jo vetëm se duhet të ruhet dhe përcillet brez pas brezi, por rasti i këtyre vajzave dhe grave dëshmon se mund të shërbejë edhe si vlerë shumë e rëndësishme zhvillimore", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se duke e luftuar korrupsionin, do të kursehen edhe më shumë fonde dhe do të sigurohen edhe më shumë mbështetje për veprimtari të ngjashme si të organizatës "Dita", duke ofruar më shumë mundësi e hapësirë për të rinjtë në përgjithësi dhe për vajzat në veçanti.

Flet për "Epokën e re", Bajram Hasani

Haradinaj e fuqizo

Anëtari i kryesisë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Bajram Hasani, ka thënë se është e dukshme rritja e kësaj partie në Anamoravë dhe në tërë Kosovën. Ai beson se në këto zgjedhje qytetarët e këtij rajoni do ta mbështesin Aleancën dhe bashkë do ta mundësojnë zhvillimin e Anamoravës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hasani ka thënë se AAK-PSD është koalicion i fitores. Pritjet për këtë fitore ai i bazon në qeverisjen e mirë të kryeministrit Ramush Haradinaj. Ai ka vlerësuar se Qeveria Haradinaj ka vendosur baza të rëndësishme për fuqizimin e shtetit të Kosovës. Hasani ka thënë se kryeministri ka vendosur një standard të ri në politikëbërje në Kosovë duke ndërmarrë veprime që treguan se ky vend ka zot shtëpie. Në këtë intervistë ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë është shprehur i gatshëm të jetë pjesë e listës së AAK-së për deputet

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 25 GUSHT - Ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, e ka quajtur të dhimbshëm largimin nga Nisma Socialdemokrate. Ai ka thënë se ka qenë i vështirë largimi nga subjekti të cilin e ka themeluar në Komunën e Gjilanit. "Realisht të punosh gjatë në një vend apo për

një subjekt dhe më pas të dalësh nga aty sigurisht se është e vështirë, sidomos kur je themelues dhe ke punuar shumë për atë subjekt. Të punosh gjatë, të japësh mund e sakrificë dhe përpjekje të jashtëzakonshme për një subjekt është ndarje e dhimbshme, por janë disa rrethana që të bëjnë të largohesh pa menduar dy herë. Jam shumë i nderuar që pas më kanë ndjekur

edhe njerëzit me të cilët kemi punuar bashkë. Pothuajse e gjithë kryesia që ka qenë atje është larguar në të njëjtën kohë me mua. Ky fakt është një tregues se gjatë atyre viteve pune dhe përkushtim kam qenë i sinqertë me të gjithë dhe çdo punë të mirë e kemi bërë bashkë", ka deklaruar Hasani në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". Ai ka bërë me dije se vendimet e

kryeministrit Haradinaj për fuqizimin e shtetit të Kosovës e kanë shtyrë t'i bashkohet Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). "Të punosh përkrah një burri siç është Ramush Haradinaj është nder i veçantë. Me kryeministrin Haradinaj na ka lidhur puna dhe angazhimi prej kohës kur si opozitë i kemi kundërshtuar marrëveshjet e dëmshme që atë

botë ishin bërë në dëm të Kosovës. Aty e kam parë një njeri të vendosur dhe një karakter të pathyeshëm kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kufijve të Kosovës dhe interesave të këtij vendi", është shprehur Hasani. Ai nuk e ka mohuar mundësinë që të jetë kandidat për deputet i koalicionit AAK-PSD, por ka thënë se për këtë vendosin kryesia dhe këshilli drejtues.

shtetin e Kosovës



Sidoqoftë, Hasani ka deklaruar se AAK-PSD është koalicioni i fitores. "Një gjë është e sigurt, se Aleanca po shkon drejt fitores. Puna dhe veprimet e subjektit tonë kanë treguar se ne jemi për një shtet të drejtë, ku qytetarët janë të gjithë të barabartë. AAK-ja dhe PSD-ja janë koalicioni i fitores. Në listën e këtij koalicioni është e sigurt se do të jenë gra e burra që janë të dëshmuar në politikën e

Kosovës", ka theksuar ai, duke shtuar se krijimi i koalicioneve të tjera nuk e dëmton koalicionin AAK-PSD.

"Epoka e re": Z. Hasani, ju tanimë jeni pjesë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), por në opinion pak keni folur për largimin nga Nisma Socialdemokrate. A qe vendim i vështirë largimi nga një subjekt

politik, themelues i të cilit ishit në Gjilan?

Hasani: Realisht të punosh gjatë në një vend apo për një subjekt dhe më pas të dalësh nga aty sigurisht se është e vështirë, sidomos kur je themelues dhe ke punuar shumë për atë subjekt. Të punosh gjatë, të japësh mund e sakrificë dhe përpjekje të jashtëzakonshme për një subjekt është ndarje e dhimbshme, por janë disa rrethana që të bëjnë të largohesh pa menduar dy herë. Jam shumë i nderuar që pas më kanë ndjekur edhe njerëzit me të cilët kemi punuar bashkë. Pothuajse e gjithë kryesia që ka qenë është larguar në të njëjtën kohë me mua. Ky fakt është një tregues se gjatë atyre viteve punë dhe përkushtim kam qenë i sinqertë me të gjithë dhe çdo punë të mirë e kemi bërë bashkë. Tashmë opinioni i di arsyet e largimit tim dhe kjo është hera e fundit që unë flas për atë periudhë. Kam thënë edhe më herët se ai është një kapitull i mbyllur. Ditën kur jam dorëhequr dhe deri në fund e kam thënë se unë do të vazhdoj me kokën lart sepse çdo gjë e kam bërë me punë, përkushtim të madh, nder dhe dashuri për njerëzit e mi, qytetarët e Gjilanit dhe të Kosovës.

"Epoka e re": Pse zgjodhët AAK-në si adresë për ta vazhduar karrierën politike?

Hasani: Të punosh përkrah një burri siç është Ramush Haradinaj është nder i veçantë. Me kryeministrin Haradinaj na ka lidhur puna dhe angazhimi prej kohës kur si opozitë i kemi kundërshtuar marrëveshjet e dëmshme që atë botë ishin bërë në dëm të Kosovës. Aty e kam parë një njeri të vendosur dhe një karakter të pathyeshëm kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kufijve të Kosovës dhe interesave të këtij vendi. Pastaj, ky bashkëpunim ka vazhduar edhe pas ardhjes në pushtet. Për një vit sa kam qenë pjesë e kabinetit të Ramush Haradinajt si ministër i Tregtisë dhe Industrisë kemi bashkëpunuar në mënyrë tejet korrekte. Gjatë kohës sa kam qenë ministër Haradinaj, ndonëse ka kërkuar shumë punë nga ne ministër, asnjëherë nuk është përzier në kompetencat tona dhe kur na është dashur ndihma e tij, ka qenë i gatshëm në çdo kohë. Kjo edhe krejt veprimet e tij gjatë kohës sa ka qeverisur si krijimi i ushtrisë së Kosovës, mbrojtja e prodhuesve vendorë, por edhe e konsumatorëve, duke i vendosur taksë të qindpërqindtë prodhimeve serbe, mbrojtja me çdo

kusht e territorit të Kosovës nga rreziku që i cenohej për copëtim, më kanë shtyrë edhe më shumë që unë t'i bashkohem shtëpisë së madhe, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Përkundër luftës së vazhdueshme, kundërshtimeve si nga faktori vendor dhe nga ai ndërkombëtar, Haradinaj ka vendosur një standard të ri në politikëbërje në Kosovë. Me veprimet e tij ai ka treguar se ky vend ka zot shtëpie. Shumë prej nesh kemi qenë skeptikë se iniciativat e tij për ushtrinë dhe taksën do të shkojnë deri në fund. Por, fatmirësisht, u tregua se kur punon drejt dhe në të mirë të qytetarëve, asgjë nuk është e pamundshme.

"Epoka e re": Së shpejti pritet të shpallen zgjedhjet e parakohshme parlamentare. A do të jeni kandidat për deputet?

Hasani: Pas shpërndarjes së Kuvendit tashmë i është hapur rruga zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Unë në AAK kam shkuar pa kushte dhe për kandidatët të cilët do të garojnë në këto zgjedhje do të vendosin strukturat e partisë. Cilido qoftë vendimi i kryesisë dhe këshillit drejtues unë do të pajtohem me ta. Një gjë është e sigurt, se Aleanca po shkon drejt fitores. Puna dhe veprimet e subjektit tonë kanë treguar se ne jemi për një shtet të drejtë, ku qytetarët janë të gjithë të barabartë. AAK-ja dhe PSD-ja janë koalicioni i fitores. Në listën e këtij koalicioni është e sigurt se do të jenë gra e burra që janë të dëshmuar në politikën e Kosovës. Ky është një koalicioni i fuqishëm. Nderi, atdashedashuria dhe puna janë vlerat që bartin emrat e listës së këtij koalicioni.

"Epoka e re": AAK-ja nuk ka fuqi të madhe në Anamoravë. Cili do të jetë kontributi juaj për fuqizimin e kësaj partie në këto zgjedhje?

Hasani: Në fakt ky konstatim nuk qëndron. AAK-ja që prej themelimit të saj në Anamoravë e ka një elektorat stabil i cili dita-ditës po rritet. Emra të rëndësishëm të AAK-së janë nga rajoni i Anamoravës. Gjatë kësaj kohe sa jam në AAK kam dalë pothuajse çdo ditë dhe jam takuar me njerëz në Gjilan, Kamenicë dhe Viti, tek ata kam parë një disponim të mirë pro Ramush Haradinajt. Rritja e AAK-së në krejt Kosovën, por edhe në rajonin prej nga vij unë, është e evidente. Nuk dua të jap fjalë të mëdha, por do ta jap kontributin tim maksimal në Anamoravë dhe Kosovë. Dua t'i falënderoj me këtë rast të gjithë anëtarët dhe drejtuesit e AAK-së

për pritjen e jashtëzakonshme që më kanë bërë. Qytetarët e Anamoravës tash e kanë kuptuar se edhe ata vetë fuqizohen duke i votuar njerëzit e tyre, njerëzit e rrethit të vet. Besoj se në këto zgjedhje qytetarët e Anamoravës do të na mbështesin dhe bashkë do ta mundësojmë një zhvillim më të madh të rajonit tonë. Besoj se ata e kanë parë angazhimin e jashtëzakonshëm të kryeministrin Haradinaj, por edhe timen sa kam qenë ministër për Gjilanin, Kamenicën e Vitinë. Ka ardhur koha e njerëzve të zotë e të ndershëm të këtij rajoni që i ka dhënë shumë Kosovës, por gjithnjë ka mbetur i lënë pas dore.

"Epoka e re": AAK-ja tashmë ka zyrtarizuar koalicionin parazgjedhor me PSD-në, mirëpo z. Haradinaj pati shpresuar se këtij koalicioni do t'i bashkohen edhe AKR-ja dhe Nisma të cilat të premten kanë bërë koalicion dhe garojnë me një listë të përbashkët. Arritja e koalicionit Nisma-AKR e ka zbehur fitoren që po pretendon të ketë në këto zgjedhje koalicioni AAK-PSD?

Hasani: Secila parti i bën llogaritë e veta dhe vendos se me kë do të hyjë në koalicion. Këto janë çështje të ndara dhe nuk besoj se ky koalicion apo ndonjë tjetër do ta zbehë apo do të na dëmtoj neve. Unë mendoj se koalicioni AAK-PSD duhet të jetë i hapur për partitë që u vijnë pas.

"Epoka e re": Çfarë pritjesh keni nga zgjedhjet e parakohshme?

Hasani: Kosovën e presin edhe më tej sfida të mëdha. Qeveria e Ramush Haradinajt ka vendosur baza të rëndësishme të fuqizimit edhe më të madh të shtetit të Kosovës. Krijimi i ushtrisë, faktorizimi i vendit tonë në dialog përmes vendosjes së taksës, mbrojtja e kufijve të Kosovës dhe ndalja e copëtimit, ndalimi me ligj i kazinove, mbrojtja e prodhuesit dhe konsumatorit tonë, Ligji për Trepçën dhe shumë vendime të mëdha të kësaj qeverie na kanë vënë në një pozitë më të volitshme. Ne kemi ende shumë për të bërë. Do të jemi fitues dhe në mandatin e ardhshëm do të punojmë edhe më shumë për qytetarët. Qeveria e ardhshme e Ramush Haradinajt do të garantojë një jetë më të dinjitetshme për qytetarin të cilin e kemi në rend të parë. Çdo vit do t'i rrisim pagat minimumi 10 për qind. Qytetarit të Kosovës do t'i krijohen kushte të dinjitetshme për të jetuar dhe nuk do të ketë arsye për t'u larguar më nga vendi.

Pacolli kërkon nga BE-ja të veprojë pas sulmit të autobusit në Serbi

PRISHTINË, 25 GUSHT (ER)- Të shtunën në mbrëmje në Serbi është sulmuar një autobus me udhëtarë të Kosovës gjatë rrugës për në shtetet e Bashkimit Evropian.

Për këtë rast ka reaguar ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Ai përmes një postimi në rrjetin social në "Twitter" ka kërkuar

nga Bashkimi Evropian që Serbia t'i ndalë sulmet dhe të ofrojë siguri për qytetarët e Kosovës. "Unë e dënoj fuqishëm sulmin ndaj autobusit të mbushur me udhëtarë që po udhëtonin nga Kosova nëpër Serbi për në Bashkim Evropian. Serbia vazhdimisht po dështon të ofrojë siguri për udhëtarët tanë dhe liri të lëviz-

jes. Ne bëjmë thirrje për hetime dhe garanci për sigurinë e qytetarëve tanë", thuhet në postimin e tij.

Pacolli ka shtuar se sulmet e koordinuara ndaj qytetarëve të Kosovës duhet të ndalen dhe ka bërë thirrje ndaj Bashkimit Evropian që të veprojë si lehtësues i marrëveshjes për lëvizje të lirë.



Haradinaj në Deçan: Aleatët na lanë hapësirë për vendime të mëdha

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kryeministër në detyrë Ramush Haradinaj ka thënë se ushtria, ruajtja e tërësisë territoriale, rikthimi resurseve të Kosovës si Trepça dhe ruajtja e substancës ekonomike, është bërë me ndihmën e aleatëve, pasi sipas tij, aleatët i lanë hapësirë për të marrë vendime të mëdha



EPOKA E RE Qendresa RAMA

DEÇAN, 25 GUSHT (ER)- Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, të dielën është takuar me strukturat e partisë në Deçan.

Ai ka thënë se Deçani gjithmonë është rreshtuar në anën e drejtë të historisë. "Dhe tani do t'i thotë po drejtimin të ri që ka marrë vendi, nga përshtatja në vendimmarrje sovraane, për

t'i përmbyllur temat nacionale në Kosovë. Krahas vendimeve të rëndësishme jetike dhe përballjen për ndalimin e projekteve të rrezikshme për vendin, vëmendjen asnjëherë nuk e kemi larguar nga transformimi i brendshëm ekonomik", është shprehur Haradinaj.

Ai ka theksuar se gjatë kësaj qeverisjeje vepruese, aleatët na kanë lënë hapësirë për vendime të mëdha, ku ka përmendur ushtrinë dhe tërësinë territoriale. "Siç është ushtria,

ruajtja e tërësisë territoriale, rikthimin e resurseve të Kosovës si Trepça dhe ruajtjen e substancës ekonomike. Ata e duan Kosovën partner të qën-

drueshëm, dhe jo servilizëm. Strukturat e AAK-së në Deçan i japin krah konceptit fitues 100 për qind shtet, për të hyrë sigurt në etapën e gjenerimit

të resurseve të vendit dhe vendosjes së një shoqërie të drejtë", ka deklaruar kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj.

Jashari: Në sistemin arsimor në Kosovë politika është mjaftë e pranishme



PRISHTINË, 25 GUSHT- Sektori i arsimit në Kosovë është mjaftë i politizuar dhe ky politizim ka ndodhur në secilin mandat qeverisës. Kështu ka thënë për "Kosovapress" kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (ShBASHK), Rahman Jashari.

Jashari duke folur për të mirat dhe të këqijat e çdo qeverisje të deritanishme në Kosovë, ka thënë se politika e ka dëmtuar sistemin arsimor.

Sipas tij, mësimdhënësit që dalin në pensionim nuk po lejohen ta

përfundojnë vitin shkollor ndonëse janë pensionuar, pasi që partitë politike po synojnë që ato vende të zihen nga bashkëpartiakët e tyre.

Kryetari i SBASHK-ut ka thënë se ai nuk anon ndaj asnjë partie politike, por që do të jetë gjithmonë me atë qeveri e cila do të punojë për përmirësimin e sistemit arsimor në vend.

Sipas tij, lehtësisht mund të vërtetohet se ai nuk është me asnjë parti politike, pasi që asnjë nga fëmijët e tij nuk janë të punësuar edhe pse kanë përfunduar shkollimin.

Policia arreston tetë persona për skema piramidale dhe bixhoz të paligjshëm

PRIZREN, 25 GUSHT (ER)- Njësia Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion në Prizren, në kuadër të Policisë së Kosovës, ka arrestuar tetë persona të dyshuar për "Organizim të skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", thuhet në një

komunikatë të Policisë së Kosovës.

Arrestimet vijnë pas aksionit në trembëdhjetë lokacione ku në tetë prej tyre janë sekuestruar dëshmi si "kompjuterë, telefona mobilë, para dhe tiketa të lojërave të fatit. "Në lidhje me këtë operacion

janë intervistuar personat e dyshuar, ndërsa për ecurinë e zbatimit të urdhër-kontrollit në vazhdimësi është informuar prokurori i shtetit dhe me vendim të prokurorit shtatë nga personat e arrestuar janë ndaluar për 48 orë", theksohet në komunikatën e policisë.



Përkujtohet dhe nderohet Ismet Jashari - "Kumanova" në 21-vjetorin e rënies

Në Kleçkë zbulohet busti i komandant 'Kumanovës'

Ismet Jashari, i njohur si komandant "Kumanova", ka rënë heroikisht 21 vjet më parë. Në nderim të jetës dhe veprës së tij të dielën në Kleçkë është zbuluar busti i komandant "Kumanovës". Në ceremoninë e zbulimit të këtij busti ka marrë pjesë edhe bashkëluftëtari i "Kumanovës", Fatmir Limaj. Ai ka thënë se busti i Ismet Jasharit është shenjë për t'u treguar gjeneratave që vijnë se sa shumë kjo zonë lidhet me lirinë e Kosovës. Komandant "Kumanova" është përkujtuar edhe nga Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Ramush Haradinaj



tjerëve, ta kthejmë në kujtim për veprat e tyre që do të na shërbenin ta vazhdonim fuqishëm luftën ku e lanë ata. Brigada 121 pësoi një goditje të madhe nga korriku e deri më 25

gusht, humbëm 14 luftëtarë e që ishte 70 për qind e udhëheqjes së brigadës, pra ishin drejtues të saj", ka thënë Limaj, duke kujtuar rënien e komandant "Kumanovës". "Në

takimin e 25 gushtit, pas betejës së përgjakshme dhe rënies heroike të Ismetit e burrave të tjerë si dhe plagosjes së disa shokëve, ne u mbledhëm dhe në atë çast kritik vendosëm dhe u ribetuam që kjo goditje e rëndë që na shkaktoi plagë do të na dhembë, por do ta kthejmë në forcë për ta rifuqizuar brigadën tonë e cila nuk u shua, por u fuqizua shumë deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës. Sukseset e Brigadës 121 janë arritur për faktin se kishte rregull dhe gatishmëri për sakrificë. Vetë rënia e Kumanovës tregon se sa ka qenë e përkushtuar Brigada 121", është shprehur Limaj.

Më tutje, Limaj ka thënë se busti i komandant "Kumanovës" është shenjë për t'u treguar gjeneratave që vijnë se sa shumë kjo zonë lidhet me lirinë e Kosovës. "Emri i Ismet Jasharit iu dha rrugëve, shkollave, iu dha Kosovës së lirë. Dhe ne sot zbuluam edhe bustin e tij te shkolla 'Ismet Jashari-'Kumanova', shkollë e përbashkët e dy fshatrave, Javor dhe Luzhnicë. Pas kaq viteve banorët e kësaj zone po i ruajnë shenjat e luftës sonë të lavdishme, shenjat e heronjve tanë, dëshmorëve tanë. Këta banorë në vazhdimësi kërkojnë që të mos shkëputet lidhja me luftën e lavdishme të UÇK-së. Busti është shenjë shtesë e fuqishme për t'u treguar gjeneratave që vijnë se sa shumë kjo zonë lidhet me lirinë e Kosovës. U jemi mirënjohës intelektualëve dhe banorëve të këtyre dy fshatrave që në luftë u angazhuan bashkë me ushtarët, por edhe që po i mbajnë të fuqishme lidhjet me të kaluarën tonë të lavdishme. Lavdi e përjetshme komandant Kumanovës dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë e Kosovës!", ka theksuar Limaj.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

KLEÇKË, 25 GUSHT - Me rastin e 21-vjetorit të rënies së Ismet Jasharit, i njohur si komandant "Kumanova", të dielën është bërë zbulimi i bustit të tij në Kleçkë të Malishevës. Në ceremoninë e zbulimit të këtij busti ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri në detyrë dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili ka qenë i pandashëm me komandant "Kumanovën" gjatë luftës së UÇK-së. Limaj ka thënë se komandant "Kumanova" i ka dhënë madhësi dhe lavdi historisë më të re të Kosovës. "U mbledhëm sërisht në Kleçkë për ta kujtuar atdhetarin dhe trimin Ismet Jashari - 'Kumanova', bashkë me shumë të tjerë që ia falën jetën lirisë së shenjtë dhe historisë sonë i dhanë madhësi e lavdi. Ne kishim marrë një goditje të jashtëzakonshme, shumë të rëndë para 21 vjetësh. Ishim para opsionit që nga kjo goditje të gjunjëzohemi apo ta kthejmë në forcë", ka thënë Limaj, duke shtuar se rënia e "Kumanovës" ishte forcë për mobilizim të radhëve të UÇK-së. "Ishte një moment që UÇK-ja në këtë zonë të rimobilizohet për ta vazhduar rrugën e shokëve tanë apo të zhdukej dhe të ndërpritej ëndrra për

çlirim. Nëse do të ndaleshim do të tradhtonim gjakun e atyre që ne i humbëm. Nëse do të ndaleshim, forcat serbe do të futeshin në këto zona dhe do t'i masakronin familjarët tanë e popullin që ishte strehuar. Pas kësaj goditje e dy dilemave, ne vendosëm që dhimbjen që na u shkaktua me vrasjen e komandant 'Kumanovës' e shumë të

'Kumanova' përkujtohet nga Thaçi, Veseli e Haradinaj

Përpos Fatmir Limajt, komandant "Kumanova" është përkujtuar edhe nga liderët shtetërorë dhe partiakë. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se komandant "Kumanova" ishte një nga luftëtarët më të mëdhenj të UÇK-së. "Në 21-vjetorin e rënies, kujtojmë Ismet Jasharin - komandant 'Kumanovën', një nga luftëtarët më të mëdhenj të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sakrifika e tij për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës është dëshmia më e mirë e vlerave kombëtare të luftës sonë, së cilës iu bashkuan luftëtarë nga të gjitha trojet shqiptare", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se komandant

"Kumanovën" do ta kujtojnë gjithmonë si atdhetar të madh, të guximshëm dhe të pathyeshëm. "Ismet Jashari - komandant 'Kumanova', ishte një prej luftëtarëve më të hershëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. 'Liria e një populli fitohet vetëm me gjak!' - thoshte gjithmonë dhe për lirinë tonë e dha edhe jetën. Sot, në 21 vjetorin e rënies heroike, e kujtojmë si atdhetar të madh, të guximshëm dhe të pathyeshëm. Rënia e tij, në përpjekje për t'i marrë trupat e ushtarëve të rënë, ishte një humbje e madhe për UÇK-në", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Në anën tjetër, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se Ismet Jashari kishte ard-

hur nga Kumanova në mbështetje të lirisë dhe çlirimit të Kosovës. "Ismet Jashari erdhi nga Kumanova në mbështetje të lirisë dhe çlirimit të vendit. Në 21-vjetorin e rënies së tij heroike, me nderim kujtojmë të gjithë dëshmorët e Brigadës 121 të Zonës Operative të Pashtrikut, që me krenari mbajti emrin e komandant Kumanovës. Kujtojmë betejat dhe përpjekjet e kësaj brigade të lavdishme, në mbrojtje të pozicioneve të luftës dhe popullatës së zhvendosur në malet e Berishës dhe dëshmorët që ranë në ofensivat e gushtit, Habib Zogaj, Gani Kastrati, Nuh Mazreku, Afrim Buçaj dhe Zenun Mataj nga Baballoqi. Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Asistenca sociale për 25 mijë familje, e mjaftueshme vetëm për të mbijetuar

Kosova vazhdon të jetë një ndër vendet më të varfra në rajon. Sipas statistikave zyrtare, numri i familjeve me gjendje të rëndë ekonomike që marrin asistencë sociale nga buxheti i Kosovës arrin në rreth 25 mijë, me rreth 110 mijë anëtarë. Muhamet Gjocaj, ish-drejtor i Departamentit të Mirëqenies Sociale që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka thënë se shuma e ndarë si asistencë sociale nuk mund ta tejkalojë situatën sociale

PRISHTINË, 25 GUSHT - Numri i familjeve me gjendje të rëndë ekonomike që marrin asistencë sociale nga buxheti i Kosovës arrin në rreth 25 mijë, me rreth 110 mijë anëtarë. Baza e politikave sociale në Kosovë përbëhet kryesisht nga skema e ndihmës sociale, skema e pensioneve, ku përfshihen pensionet e moshës dhe kontributdhënëse, pensionimet e parakohshme të disa ndërmarrjeve, beneficijet për veteranët e luftës si dhe për kategori të tjera sociale.

Të gjitha këto skema buxhetit të Kosovës vitin e kaluar i kanë kushtuar më shumë se 416 milionë euro, apo 20 për qind të shumës së përgjithshme, thuhet në një hulumtim të Institutit për Studime të Avancuara GAP, të titulluar "Si shpenzon shteti paratë tona?". Vetëm në skemën e ndihmës sociale, që jepet për familjet që jetojnë në kushte të rënda ekonomike, sipas raportit gjashtëmujor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, janë të përfshirë rreth 25 mijë familje. Numri më i madh i familjeve

është nga komuna e Mitrovicës, me 2 324 familje apo mbi 9 për qind, nga numri i përgjithshëm. Sipas ligjit, këto familje, si pjesë e skemave sociale, marrin një pagesë prej 50 deri në 150 euro në muaj, varësisht nga numri i anëtarëve.

Familja pesanëtarëshe Gashi nga Prishtina është një nga familjet e shumta që merr asistencë sociale. Miradija, nënë e tre fëmijëve, ka thënë se në muaj merr nga 87 euro si asistencë sociale dhe që kjo shumë nuk i mjafton as për t'i përmbushur nevojat elementare të familjes. "Janë të pamjaftueshme, fillimisht me atë pagesë i paguaj faturat e energjisë dhe mendoem që të tjerat t'i kursej për bukë, tjetër nuk mundem të blej. Djali i madh më kërkon veshmbathje, të vegjlit kërkjnë para kur nisen në shkollë, po nuk më mbesin para", ka thënë Miradija.

Asistenca sociale, të cilën e ofrojnë institucionet e Kosovës për familjet në nevojë që nga viti 2003, është treguar e pamjaftueshme për shportën e një familjeje të

kësaj kategorie.

Muhamet Gjocaj, ish-drejtor i Departamentit të Mirëqenies Sociale që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se shuma e ndarë si asistencë sociale nuk mund ta tejkalojë situatën sociale. "Shuma është e pamjaftueshme. Shuma e ndihmës sociale vetëm mund të parandalojë për të mos degradojë më keq. Përndryshe, parashihet me mjete të tjera të stimulohet familja, aty ku ka mundësi të punësohet ndonjë anëtar i familjes, sepse kjo gjendje është vetëm sa për t'i mbajtur gjallë", ka thënë Gjocaj. Sipas të dhënave zyrtare, shkalla e varfërisë në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 23 për qind. Nga kjo shifër mbi 17 për qind llogaritet varfëria e përgjithshme (që njerëzit janë të varfër me atë që konsiderohet të jetë standard i kërkesave minimale), kurse mbi 5 për qind varfëria ekstreme (që tregon se njerëzit janë të varfër, pasi nuk mund t'i përmbushin nevojat themelore në ushqim). Muhamet Gjocaj ka thënë se

shuma e ndarë e mjeteve nga buxheti për familjet me asistencë sociale është më e ulëta nëse krahasohet me skemat e tjera sociale. "Nuk është buxhet i lartë, më së paku jepet për varfëri në Kosovë, duke pasur parasysh se e vetmja skemë është me të cilën matet varfëria. Të gjitha skemat e tjera jepen për diçka tjetër ose për moshë ose për kualifikime të invaliditetit ose për pjesëmarrje në luftë dhe të gjitha këto nuk kanë fare për bazë krahasimin me varfërinë. Kjo skemë, në vit, llogaritet të jetë 28-30 milionë euro, kurse mbi 100 milionë euro jepen për skema të tjera", ka thënë ai. Nga hulumtimet e bëra nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, ishte theksuar se vlera e asistencës sociale për një muaj nuk përshtatet me nevojat e familjeve në bazë të madhësisë apo strukturës së tyre. Shporta mujore e një qytetari në Kosovë llogaritet të jetë 115 euro, konsumi për ekonomitë familjare mbi 7 500 euro në vit, shumë kjo që nuk siguron një standard të mirë jetësor për qytetarët.



AUVK-u asgjësoi mbi 300 mijë kilogramë produkte ushqimore gjatë këtij viti

PRISHTINË, 25 GUSHT (ER) - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK) ka asgjësuar mbi 300 mijë kilogramë produkte ushqimore të dyshimta për konsum gjatë këtij viti.

Zëdhënësi i AUVK-ut, Lamir Thaçi, në një intervistë për "Ekonomia Online", ka thënë se inspektorët e angazhuar janë në terren për të bërë kontrolle të operatorëve ekonomikë ashtu që produktet që nuk i përmbushin kushtet për konsum të mos bien në duart e konsumatorëve. "Deri më tani produktet me origjinë shtazore, afërsisht rreth 70 mijë kilogramë/litra, varësisht nga njësia matëse e produktit, kemi edhe produkte të tjera të cilat janë asgjësuar. Si produkte, mund të them se deri më tani ka kaluar mbi 300 mijë kg/litra, në total të gjitha produktet nga të tri inspektoratet që veprojnë në kuadër të AUVK-ut", ka thënë ai. Thaçi ka theksuar se në këtë vit ka pasur vetëm një rast të paraqitur si të dyshuar për produkte të cilat kanë sjellë helmim të njerëzve. Për këtë, ai ka shtuar se kanë paraqitur fletëparaqitje në

gjykatë për të rezultuar me mbylljen e operatorit i cili ka bërë shkelje të ligjit. "E kemi pasur një rast të dyshuar në Drenas dhe në koordinim me inspektorët komunalë dhe zyrtarë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik janë ndërmarrë të gjitha veprimet. Si autoritete të koordinuara kemi vepruar me kohë dhe janë marrë masat ligjore, është bërë mbyllja ligjore, është bërë mbyllja e restorantit si dhe janë marrë mostrat dhe strishot e nevojshme të cilat kërkohen për hulumtim të rastit kur kemi të bëjmë me dyshimet në helmim. Disa nga mostrat kanë rezultuar pozitive dhe sipas procedurës ligjore, kemi iniciuar fletëparaqitje për gjykatë, ashtu si kërkohet me ligj", është shprehur Thaçi.

Më tutje, ai ka thënë AUVK bën edhe inspektimin e pishinave në aspektin hidro-sanitar për të siguruar qytetarët për ujin në pishina. Në këtë kontekst, Thaçi ka thënë se gjatë këtij viti nuk kanë marrë asnjë ankesë prej tyre rreth kushteve higjienike në pishinat e Kosovës. "Ne në muajt e kaluar kemi marrë një aksion



dhe i kemi inspektuar pothuajse të gjitha pishinat në nivel vendi dhe niveli i përgjithshëm i kushteve higjieno-sanitare në pishina ka qenë nivel i mirë, i cili i ka plotësuar kushtet për punë. Aty ku ka pasur nevojë për vërejtje të vogla teknike të cilat është dashur të kryhen, i kemi evidentuar dhe i kemi dhënë afatet kohore për të gjitha pishi-

nat në nivel vendi dhe ato janë rregulluar. Pishinat në Kosovë kanë kushte të cilat ofrojnë shërbime të sigurta për konsumatorë të tyre", ka deklaruar Thaçi. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK) ditë më parë ka asgjësuar 21 tonë mish që mbahej në depon e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), e cila ndodhet në Veternik

të Prishtinës. Thaçi ka deklaruar se ky institucion ka konstatuar se në depon e BIK-ut nuk ka pasur kapacitet për ftohje dhe se ngrirja nuk është bërë me kohë. Ai ka thënë se inspektimin e kanë bërë pas kërkesës zyrtare nga BIK-u. Thaçi ka bërë me dije se mishi është asgjësuar dhe propozur në deponinë e mbe- turinave në Obiliq.

Largohen dy trafo nga prona e 'Trepçës'

**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 GUSHT - Dy trafo elektrike janë zhvendosur nga prona e ndërmarrjes "Trepça". Lajmin e ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të "Trepçës", Shyqyri Sadiku, i cili ka thënë se nuk i di arsyt pse janë duke u bartur këto dy trafo dhe për këtë ka kërkuar sqarime nga KEDS-i. "Ne nuk e dimë pse KEDS-i është duke i bartur këto dy trafo dhe po rrezikohemi që në rast se do të ketë ndonjë avari siç ka ndodhur para pesë muajsh, atëherë minatorët tanë do të mbesin të ngujuar, pasi s'kemi ndonjë alternativë tjetër", ka thënë Sadiku.

Ndërsa zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se dy trafot e tërhequra kanë qenë jashtë funksionit. "KOSTT-i ka ndërtuar në atë pjesë nënstationin e ri 110/10 kV 'Ilirida'. Prandaj, dy trafot e tërhequra nga KEDS-i ishin jashtë funksionit, pasi ato

janë 35/10 kV. Pra, ka ndryshuar struktura e rrjetit, prandaj nuk mund të përdoren si rezervë ato pasi nuk ekziston më furnizimi nga linjat 35/10 kV dhe po t'i lëmë aty ato nuk mund të vihen më në funksion", ka thënë Buzhala.

Në anën tjetër nga KOSTT-i kanë theksuar se deri në fillim të shtatorit pritet që zgjidhja e përkohshme të zëvendësohet përmes furnizimit nga nënstationi i ri 110/10(20) kV 'Ilirida'. Sipas KOSTT-it, në asnjë rrethanë kombinati "Trepça" nuk mund të lihet pa u furnizuar me energji elektrike. "Nuk pritet të ketë probleme në furnizimin e kombinatit 'Trepça' me energji elektrike. Zgjidhja e përkohshme e furnizimit është bërë nëpërmjet nënstationit 'NS Trepça' pas avarisë në dimrin e kaluar, ku KOSTT-i përmes kësaj zgjidhje, KEDS-it i ka siguruar furnizimin e kombinatit 'Trepça'. Pritet që deri në fillim të shtatorit zgjidhja e përkohshme të zëvendësohet përmes furnizimit nga nënstationi i ri 110/10(20) kV 'Ilirida'.



Në asnjë rrethanë kombinati furnizuar me energji elektrike", KOSTT-it dhënë gazetës "Epoka 'Trepça' nuk mund të jetë pa u është thënë në përgjigjen e e re".

Zgjidhet problemi i ujit të pijshëm në disa lagje të kryeqytetit

PRISHTINË, 25 GUSHT (ER) - Kryeshefi i Kompanisë Rajonale të Ujësjesit (KRU) "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka bërë me dije se kanë arritur ta zgjidhin problemin e ujit të pijshëm në disa lagje të Prishtinës. Ai ka thënë se evitimi i këtij problemi ka qenë i komplikuar teknikisht. "Pas një pune intensive njëjavore që ekipet e operatives dhe detektimit kanë bërë

duke kontrolluar një zonë të madhe të rrjetit të ujit, arritëm ta zgjidhim problemin e ujit të pijshëm për lagjet: Arbëri, Dardani, Lakrishtë dhe një pjesë të Emshirit. Problemi ishte teknikisht i ndërlikuar, por fatmirësisht është zgjidhur. Falënderojmë konsumatorët për mirëkuptim!", ka shkruar Abdullahu në llogarinë e vet në "Facebook".



Asfaltohen tri rrugë në Pojatë të Ferizajt

FERIZAJ, 25 GUSHT (ER) - Në fshatin Pojatë të Ferizajt janë asfaltuar tri rrugë me një gjatësi prej 1.5 kilometrash nga 15 rrugë sa do të asfaltohen në këtë fshat me një kosto prej 240 mijë eurosh. Për t'i parë nga afër punimet dhe vlerësuar cilësinë e standardet e aplikuara në këtë projekt, ka dalë në terren kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, i cili shoqërohej nga drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës,

Arbër Bytyqi.

Bytyqi ka thënë se projekte të tilla, kaq të gjëra në shtirje dhe rëndësinë që paraqesin ato për banorët e këtyre zonave rurale, janë planifikime të qeverisjes lokale, të realizuara me përkushtimin më të lartë, për t'ua lehtësuar qarkullimin dhe jetën qytetarëve. "Në fshatin Pojatë po bëjmë asfaltimin e disa rrugicave që kemi në kuadër të projektit. Asfaltimi i tri

rrugicave tashmë ka përfunduar me një gjatësi rreth 1.5 kilometra, që do të përfundohet këto ditë, kurse pjesa tjetër e rrugicave do të vazhdojë gjatë këtij viti, kurse pjesa tjetër e mbetur do të përfundojë vitin e ardhshëm. Ky projekt kap shumën 240 mijë euro i cili do të ndikojë në përfundimin e problemeve që kanë të bëjnë me infrastrukturën në fshatin Pojatë", ka thënë Bytyqi.

Vazhdojnë punimet e projektit për korridorin Skenderaj - Vushtrri

SKENDERAJ, 25 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe inxhinierët e kësaj komune, kanë inspektuar punimet e projektit për asfaltimin e rrugës që lidh Skenderajin dhe Vushtrrinë. Kryetari Jashari ka bërë me dije se në kuadër të këtij projekti do të asfaltohen rreth 15 kilometra rrugë. "Së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe inxhinierët e komunës kemi

inspektuar punimet e projektit në realizim e sipër të asfaltimit të rreth 15 kilometrave nga fshatrat rreze Qyqavicës, që vazhdon përgjatë fshatrave të Komunës së Vushtrrisë, ku edhe është përfundimi i këtij projekti. Ky projekt ka nisur ditë më parë dhe synon që veç asfaltimit të rrugëve të fshatrave tona, të krijojë edhe një korridor tjetër të lidhjes Skenderaj - Vushtrri, duke shkurtuar distancat ndërmjet vendbanimeve", është shprehur Jashari.



Fillon ndërtimi i kanalit të mullirit në Irzniq të Deçanit

DEÇAN, 25 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për ndërtimin e kanalit të mullirit në fshatin Irzniq të kësaj komune. Ramosaj ka thënë se ky kanal, përpos furnizimit me ujë të mullirit, do të shpërbëjë edhe për ujitjen e

tokave bujqësore në këto anë. "Kanë filluar punimet për ndërtimin e kanalit të mullirit në Irzniq, në lagjet Mushkolaj, Dodaj, Berisha dhe Islamaj, i cili kanal e furnizon mullirin me ujë dhe njëkohësisht shërben edhe për ujitjen e tokave bujqësore!", ka deklaruar Ramosaj.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (26)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin
NOVOSELLA**

Për kontributin e madh për çështjen kombëtare, erdhëm të nderojmë Bacën Adem, ne veteranët e arsimit shqip!

31 korrik 2018,
H. Muja dhe Ramadan Pajaziti,
nga Runiku

Vepra dhe jeta e Bacës tonë të madh qëndron në themelet e lirisë së Kosovës dhe të Shqipërisë! Jam krenare që jetova në Epokën e Bacës Adem!

31 korrik 2018,
Fitore Rexhep Malaj

U linde dhe u rrite me ideale të çlirimit dhe bashkimit kombëtar! U sakrifikove për kauzën kombëtare!

Veprime gjatë tërë jetës për çlirim dhe bashkim!
Çdo gjë që kishe ia fale popullit shqiptar!

Vepra jote testament për bashkimin kombëtar!
Qoftë i përjetshëm kujtimi për veprën Tënde të pavdekshme!

31 korrik 2018,
Gani Sylja

Baca Adem,
Ishe Yll i pashuar i kombit shqiptar! Do mbetesh, përgjithmonë i paharruar!

31 korrik,
Izet Baraliu

Largimi Yt, Baca Adem, na shkaktoi dhembje të thellë në shpirt! Erdhëm për të shprehur ngushëllimet tona për familjen Tuaj dhe për gjithë shqiptarët!
Të qoftë lavdi!

31 korrik 2018,
Xhavit Sherifi, Preshevë

Sa najve?im respektom, iskrenom borcu za Slobodu i Ljudska Prava svih neoslobodjeni ljudi i politiki?kih prognanika. Neka mu je vje?ni rahmet ?ovjeku slobodnih ideja, našem saborcu, Adem Demaçi...
S'najve?im uva-avanjem!

31 Juli 2018,
Prof. Dr. Red-ep Škrelji,
Potpresednik Bosnja?kog Nacionalnog Vije?a,
Novi Pazar

Ngushëllime familjes Demaçi!
Qoftë i përjetshëm kujtimi për veprën madhore të Bacës Adem!
Pak kush gjatë historisë i shërbeu aq me besnikëri, për një jetë të tërë, si Baca!

31 korrik 2018,
Sali Zhitia

Të faleminderit për çdo sakrificë Tënde për atdhe dhe liri, Baca Adem!
Kujtimi për Ty do jetojë përherë!

31 korrik 2018,
Selatin Fazliu
(i quajtur Ballisti)

Lavdi veprës së Bacës Adem. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës, të cilës ia fali gjithë jetën!

31 korrik 2018,
Lulzim e Valbona Çela

Vepra Juaj do të jetë e përjetshme për shekuj të tërë! Lavdi e përjetshme, veprës suaj atdhetare, O Baca Adem Demaçi!

31 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Vepra Juaj, Baca Adem, do të çmohet nga Kombi përgjithmonë!
Lavdi për jetë e mot, Bacë!

31 korrik 2018,
Lavdim Xh. Shala

Baca Adem,
Vepra juaj nuk do të vdes kurrë!
Lavdinë të ruan atdheu përjetësisht!

31 korrik 2018,
Feriz Latifi

Nderimin e meritove me vepër gjatë gjithë jetës! Të kemi dashur që kur filluam të mësojmë shkronjat! Me veprën Tënde, u bërë pjesë e jetës së çdo atdhetari dhe luftëtari të lirisë! Të qoftë lavdi, Baca Adem!

31 korrik 2018,
Adem Nimani,
Kostërc, Runik

Bacë, ti ishe një hero i vërtetë, inspirim për gjithë popullin!
I paharruar do mbetesh përherë!

14 shtator 2018,
Diana Osmani, nga Londra

Amazing stories! What a brave man the Mandela of Kosovo!

14 shtator 2018
Funke Oleyoni, Love from London

During times of turmoil and oppression we love the role models like Adem Demaçi for inspiration and guidance. A true leader!

14 shtator 2018,
Patricia Z. Dizon, London



Baca Adem, jam me shumë fat që isha pranë teje për 55 vite, prej shtatorit 1963 deri në shkuarjen tënde në amshim, me 26 korrik 2018.

Selatin Novosella

Lamtumirë Anteu i lirisë

Pas varrimit madhështor të shtunën e kaluar me 28 Korrik 2018, të atdhetarit të devotshëm të çështjes kombëtare, Bacës Adem Demaçit, ku morën pjesë mijëra qytetarë, nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga mërgata, familja e ngushtë e Adem

Demaçit dhe farefisi i tij çelen të pamën për tri ditë me radhë, në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Gjatë tri ditëve, duke filluar prej orës 9 deri në ora 18, vërshuan qindra-mijëra qytetarë nga mbarë Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës, Mali i Zi dhe mërgata, duke i shprehur ngushëllime familjes krenare, Demaçi!
Vdekja e tij preku shpirtin e çdo shqiptari liridashës anembanë rruzullit tokësor, sepse pushoi së rrahuri kjo zemër e madhe shqiptare.
Adem Demaçi ishte idhull i luftëtarëve e luftëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët

luftuan me emrin e tij në gojë!
Shokët e tij të idealit, me dhembje e pikëllim të thellë, gjatë këtyre tri ditëve, pritën e përcollën pa përtesë këta vizitorë, duke qëndruar në këmbë në këtë vapë përvëluese dhe duke falënderuar të gjithë ata, që kishin ardhur për ngushëllime të familjes Demaçi!
Në vazhdim, japim emrat e shumë prej tyre që organizuan pritjen për kryeshëndosh për Bacën Adem!

Xhelal Pakashtica, Adnan Asllani, Shqipe Buja, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës

(Fund)

Hezbollah thotë se dronët izraelitë u rrëzuan në Bejrut

TEL-AVIV, 25 GUSHT - Izraeli thotë se ka sulmuar objektiva iraniane në Siri për të shkatërruar një sulm me dronë ndaj Izraelit. Pavarësisht mohimeve nga ana e Iranit, incidenti ka ngjallur tensione të reja mes Izraelit dhe Iranit. Izraeli ka dhënë urdhër për aktivizimin e sistemit të mbrojtjes me raketë në kufi me Sirinë. Ndërkohë në Liban, Hezbollahu thotë se dy dronë izraelitë janë rrëzuar gjatë natës në atë vend.

Kryeministri libanez Saad Hariri e përshkroi rrëzimin e dy dronëve si një shkelje dhe agresion ndaj sovranitetit të Libanit dhe si kërcënim për stabilitetin rajonal.

Droni i dytë ra mbi një ndërtesë që strehon qendrën mediatike të organizatës Hezbollah në dalje të kryeqytetit Bejrut të Libanit. Banorët thonë se dëgjuan zhurmën e një shpërthimi. Salem Hamzi jeton në Bejrut.

Zëdhënësi i Hezbollahut, Mohammed Afif, i tha agjencisë së lajmeve Associated Press se ata nuk kishin goditur ndonjë dron. Incidenti ndodhi disa orë pasi Ushtria izraelite tha se kishte ndërmarrë një sulm ajror pranë kryeqytetit sirian Damask, kundër një krahu të Gardës Revolucionare të Iranit. Ushtria izraelite tha se ishte përpjekur të pengonte një sulm iranian me dron ndaj Izraelit.



Dallime mes udhëheqësve në samitin e G7-s

Liderët botërorë në samitin e G7-s, vazhdojnë të jenë të ndarë për çështje si ndryshimet klimatike, përballja me Kinën dhe Iranin, apo mundësia e rikthimit të anëtarësisë së Rusisë në G7, si dhe dalja e Britanisë nga Bashkimi Evropian dhe konsensusi duket se ka pak shanse për t'u arritur

PARIS, 25 GUSHT - Udhëheqësit e vendeve më të industrializuara të botës po marrin pjesë në samitin e tyre të përvitshëm.

Grupi i të Shtatëve (G7) është mbledhur këtë vit në qytetin Biarritz, të Francës.

Përpara fillimit të samitit, presidenti amerikan Donald Trump kërcënoi se do të vendoste tarifa ndaj verës franceze, e cila përfaqëson pjesën më simbolike të industrisë së vendit. Kjo deklaratë shtoi edhe më shumë tensionin mes udhëheqësve, të cilët vazhdojnë të jenë të ndarë për çështje si ndryshimet klimatike, përballja

me Kinën dhe Iranin, apo mundësia e rikthimit të anëtarësisë së Rusisë në G7, si dhe dalja e Britanisë nga Bashkimi Evropian. Për shkak të këtyre diferencave të thella, konsensusi duket se ka pak shanse për t'u arritur. Pas sesionit të parë të së dielës, udhëheqësit nuk arritën dot një marrëveshje për ripranimin e Rusisë në G7 brenda vitit 2020. Rusia u dëbua pas pushtimit të Ukrainës dhe aneksimit të Krimesë në vitin 2014.

Pas sesionit të parë të punimeve për ekonominë globale, politikën e jashtme dhe çështjet e sigurisë,



Qeveria franceze njoftoi se udhëheqësit kishin rënë dakord që presidenti francez Emmanuel Macron t'i dërgojë një mesazh Iranit dhe të zhvillojë bisedime me zyrtarët iranianë. Nuk u dhanë detaje për përmbajtjen e këtij mesazhi dhe presidenti

Trump tha se nuk kishte diskutuar asgjë për ndonjë mesazh drejtuar Iranit apo për bisedime. Megjithatë, ai shtoi më vonë se nuk do të pengojë askënd që dëshiron të bisedojë me Iranin. Donald Tusk, presidenti i Këshillit Evropian, pranoi se "është bërë

gjithnjë e më e vështirë që të gjejmë gjuhën e përbashkët".

Presidenti francez Emmanuel Macron ka bërë të ditur se nuk do të ketë një komunikatë të përbashkët në përfundim të samitit, duke përmendur ndër arsyet mosmarrëveshjet mes presidentit Trump dhe udhëheqësve të tjerë për çështjet kyçe.

Kjo do të jetë hera e parë në historinë e G7-tës që samiti do të përfundojë pa një komunikatë.

Samiti mundësoi takimin e parë mes presidentit Trump dhe kryeministrit britanik Boris Johnson, që kur ai pasoi në këtë detyrë ish-kryeministren Theresa May, e cila nuk arriti menaxhimin e suksesshëm të procesit të daljes së Britanisë nga BE-ja-Brexit.

Vendet anëtare të G7-s janë Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Britania dhe Shtetet e Bashkuara.

Vazhdojnë protestat në Hong Kong



HONG-KONG, 25 GUSHT - Policia e Hong Kong-ut përdori të dielën gaz lotsjellës dhe nxori për herë të parë pompat e ujit në përpjekje për të shpërndarë protestuesit anti-qeveritarë.

Mijëra protestues kishin dalë në rrugë.

Të shtunën, protestat u bënë të dhunshme për herë të parë në gati dy javë, pasi qindra demonstrues të veshur me të zeza dhe të armatosur me shkopinj bejsbolli dhe shufra bamboje hodhën

bomba me benzinë dhe tulla mbi policinë.

Policia e Hong Kongut vringëlloi shkopinj të gomës dhe hodhi gaz lotsjellës për t'i shpërndarë protestuesit, të cilët kishin krijuar barrkada rrugore të improvizuara duke përdorur skela bamboje jashtë një stacioni policie dhe një qendër tregtare aty pranë.

Ndërkohë, Kina liroi një punonjës të Konsullatës britanike, Simon Cheng, ndalimi i të cilit nxiti tensione. Ai u arrestua për 15 ditë në

Shenzhen, pak larg kufirit nga Hong Kong, për gjoja shkelje të rregullave të menaxhimit të sigurisë publike.

Autoritetet thanë se respektuan të drejtat ligjore të Simon Chengut, dhe thanë se ai kishte pranuar akuzat për të cilat ishte arrestuar. Kjo është një përgjigje standarde nga Policia kineze, me gjithë faktin që Cheng nuk iu dha mundësia të mbrohej në gjykatë. Familja e Chengut tha në Facebook se ai ishte kthyer në Hong Kong.

Ushtria braziliane shton forcat për ndërhyje në zjarret masive në Amazonë

BRAZIL, 25 GUSHT - Ushtria braziliane po vendos trupa në Amazona për të luftuar zjarret masive që kanë përfshirë rajonin dhe kanë shkatërruar një zhurmë ndërkombëtare.

Ministri i Mbrojtjes i Brazilit ka thënë se rreth 44 mijë trupa do të jenë në dispozicion për operacione "të pashembullta" për të shuar zjarret, dhe forcat po shkojnë drejt gjashtë shteteve braziliane, që kërkuan ndihmë

federale. Shtetet janë Roraima, Rondonia, Tocantins, Para, Acre dhe Mato Grosso.

"Mbrojtja e pyllit është detyra jonë", tha presidenti i Brazilit Jair Bolsonaro në një fjalim televiziv. "Ne jemi të vetëdijshëm për këtë dhe do të veprojmë për të luftuar shpyllëzimin dhe aktivitetet kriminale që i vendosin njerëzit në rrezik në Amazona. Ne jemi një qeveri me tolerancë zero për krimin, dhe në fushën mjedisore

nuk do të jetë ndryshe", tha ai.

"Misioni i parë i ushtrisë do të kryhet nga 700 trupa rreth Porto Velho, kryeqyteti i Rondonia", tha ministri i Mbrojtjes Fernando Azevedo. "Ushtria do të përdorë dy avionë C-130 Hercules të aftë të hedhin deri në 12.000 litra ujë në zjarre", tha ai.

"Kjo tregon shqetësimin e qeverisë së Bolsonaros për këtë çështje", tha Azevedo.



Me udhëheqësin e popullit shqiptar Ali Ahmeti në ngushllime te familja Zekaj, për vdekjen e atdhetarit e patriotit, luftëtarit e veteranit invalid të UÇK-së, të pavdekshmit Qazim Zekaj

QAZIM ZEKAJ BIRI I LAVDISHËM I PODGURIT

Zemra e patriotit Qazim Zekaj, këtij burri të urtë, të madh e të lavdishëm të Atdheut, ndali akrepat e saj!



Ismet SYLEJMANI

U shua pergjithmonë trupi i nje shqiptari tipik, i nje mesuesi ashtu sikur porosisnin dhe thërrisnin të ishte themeluesit e Alfabetit te Gjuhes Shqipe, u shua pergjithmonë Ai që kurrë nuk e shtriu dorën përpara armiqëve, as atëherë kur ia burgosën djalit Xhevatit e ia denuan me 9 vite burg dhe ia degdisën nëpër kazamatet famëkqija jugosllave!

trupin e Qazim Zekajt i cili jetën e tij të vrullshme në shërbim të popullit e Atdheut e kishte nisur në vendlindjen e Tij, në një nga krahinat lavdimëadha të Kosovës atë të Podgurit!

Qazim Zekaj ky mesues i madh i popullit siç e kishte shënuar në telegramin e Tij Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, një jetë të tërë para luftës së UÇK-së, e kishte kaluar me ditare e laps në dorë!

Pishën e ndriqimit të shkronjave shqipe dhe të arsimit kombëtarë, kurrë nuk e kishte ulur, por e kishte mbajtur dhe ngritur lartë e më lartë!

Ka shpërndarë dritën e ditorisë, ua ka mësuar ABC qindra dhe mijëra nxënësve të Istogut me

Në nderim të këtij burri e figure të madhe të Atdheut, bashkë e në shoqërim të Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, isha në vizitë ngushlluese në familjen Zekaj në Mojtir të Istogut!

Ngjarje historike, me Ali Ahmetin, i cili shoqërohej edhe nga Zv. Kryeministri e Ministri për Politikë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut i nderuari Sadullah Duraku, nga veprimtari e ish- i burgosuri politik i nderuari Tahir Hani e nga eskorta e Tijë, po shkëlqim për herë të parë tokën liridashëse të fsh. Mojtir, për të nderuar te varri i luftëtarit të UÇK-së Qazim Zekaj, e për të ngushlluar familjen e Tij, djemt e nipat, kushërintjë, shokët e miqtë e shumë

vetëm për mesuesin luftetar Qazim Zekaj, kjo ishte nderim jo vetëm për atdhetarin Xhevat Zekaj e vëllezërit e Tij ish të burgosur politik, luftëtarë e ushtarë

Naserin, Ganiun, Azemin e Dritanin, kjo ishte nderim për familjen e fisin e Zekajve të Mojtirit, sepse aty kishte ardhur për ti nderuar ata dhe të pavdekshmin e tyre, njëri prej shqiptarëve e bijve me në zë e më besnik i popullit shqiptar!

Ata luftëtarë e çlirimtarë që i nderon e i respekton Ali Ahmeti, historia përfundimisht i mbulon pergjithmonë me krenari e lavdi heronjesh e dëshmorësh!

Podguri krahina liridashëse e shumë burrave dhe grave të

shumë patriot të mëdhenj e të dëgjuar, në mes tyre ishte edhe i madhi e i pavdekshmi Ukshin Hoti, që kurrë nuk u gjend trupi i Tij!

Lartë në Mojtir Udhëheqësi Ali Ahmeti, kishte shkuar për ngushllime te shoku i Tij i luftës, jetës e punës politikopatriotike, te atdhetari e politikani patriot çlirimtarë Xhevat Zekaj!

Nderon përpara nderit të lavdisë e të çlirimtarit të Atdheut, nderon Udhëheqësi Ali Ahmeti, ky bir besnik që në tërë jetën e Tij, shkëlqeu e shkëlqeu, në të mirë të popullit shqiptar e kombit, të njerëzimit e krahinës nga vjen dhe familjes që i takon!

Patrioti e atdhetari i madh



Në trupin e pajetë që u mbulua nga dheu i Atdheut e me flamur kombëtar, të veprimtarit të pakpromis të çështjes së kombit, nisi jetën e saj pavdekshia!

Varri në varrezat e fshatit Mojtir priti e morri brenda tij, një trup njerëzorë të një shqiptari atdhetar, i cili jo vetëm kishte vujtur e hequr të zitë e ullirit në jetë e në veprimtarinë atdhetare, por edhe ishte bërë shoshë e ishte goditur për vdekje nga plumbat dhe granatat e rafaleve dhe armëve të ushtrisë serbe, të cilat i kishin shkaktuar gjakderdhje, dhembje e plagë të mëdha e të pashërueshme kurrë plotësisht.

Gjithmonë i shkaktoi dhembje e i kulloi plaga e luftës për liri, jetoi me kujtim tepër të hidhur të çmimit të luftës së armatosur çlirimtare!

Toka e atdheut e morri brenda

rrethinë!

Luftën e armatosur çlirimtare në UÇK e ka zhvilluar në Zonën Operative të Drenicës në Brigaden e Komanduar nga Legjendari Mujë Krasniqi e më vonë Hysni Shabani!

Ka luftuar krah për krah me emra e figura të mëdha e të çelika të UÇK-së, me Gjeneralin lavdimadh, Heroin e Kombit Fehmi Lladrovci, me Gjeneralin trim e të vendosur dhëndri i Qazimit, i pavdekshmi, Heroi i Kosovës Shaban Shala, me Komandantin e Brigades 113, Gjeneralin sypatrembur Heroin e Kombit Mujë Krasniqi, me Komandantin sypatrembur, Heroin e Kombit Rasim Kiqina, me njërin prej komandantëve më në zë të Grykës së Llapushnikut, dhëndrin e Tij Elmi Shalën, por edhe me shumë emra të medhenj e të dëgjuar të luftës për liri e çlirim të Kosovës!

që me një rresht të gjatë ishin dalur në pritje e nderim!

Në ballë të rreshtit në pritje për Qazim Zekajn, ishte Djali madh i Qazimit, Xhevat Zekaj, veprimtar e atdhetar i devotshëm, bir besnik e i pathyeshëm i popullit shqiptar, shok e bashkeveprimtarë, bashkëluftëtarë e mik për jetë i Ali Ahmetit!

Ishte historike vizita!

Kjo vizitë nuk ishte vetëm ngushlluese por edhe nderuese, meritore dhe kombëtare, luftarake dhe çlirimtare, sepse në këtë krahinë nga kishte dalur edukuesi i brezave dhe plaku i UÇK-së, kishte ardhur njëri prej atyre që e ka ndezur përfundimisht luftën e popullit shqiptar në ish-jugosllavi, njëri prej atyre që e ka themeluar UÇK-në, UÇPMB-në dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare! Në Mojtir ishte për vizitë Ali Ahmeti, kjo ishte nderim jo

kësaj ane, ishte atë ditë krahina më e lumtur sepse brenda sajë ka trupin e shtrenjtë të Qazim Zekajt, dhe mbi të shkelte këmba dhe hidhte hapin e tij legjendari i madh dhe çlirimtari i vërtetë i tokave të pushtuara të Atdheut e Kombit tonë i madhi Ali Ahmeti!

Përballje historike e hapsirës në tokën shqiptare të Kosovës! Lartë në Mojtir kuvendonte me burra e miq të dëshmuar të kësaj krahine Udhëheqësi Ali Ahmeti, poshtë atje jo shumë larg, dukej burgu famëkeq i Dubravës, në të cilin janë torturuar e rrahur për vdekje me qindra e mijëra shqiptarë, atdhetarë e patriot, që kanë kaluar jetën nëpër atë kasaphane njerëzore antishqiptare!

Përballë e lartë mbi burgun famëkeq ku gjatë luftës së UÇK-së, burgu u shëndërrua në një kasaphanë të vërtetë ku mbetën të vranë e të masakruar

Qazim Zekaj, do të mbahet mend gjatë shumë gjatë, për të do të mësojnë fëmijet nëpër shkolla e do të shkruaj historia për luftën e Tij me ditare e pushkë në dorë, për gjakun që ka derdhur e plagët që ka marrë, për mbijetesën titanike dhe për varrimin e tij të madh kombëtar, për pjesmarrjen në varrim të emrave e figurave të mëdha të luftës për liri, për pjesmarrjen e lartë dhe masive në ngushllime në familjen e Tij dhe do të mbahet në mend edhe për viziten në nderim të jetës dhe veprës së Tij nga themeluesi i UÇK-së e Udhëheqësi politik i popullit shqiptar Ali Ahmeti!

Lavdi e përjetshme të pavdekshmit Qazim Zekaj!

Ngushllime familjes së të pavdekshmit Qazim Zekaj!

Jetë të gjatë e suksese të medha Ali Ahmetit!

Prishtinë, 24 Gusht 2019!

E rrallë

Liçeni që fsheh një sekret të errët

Liçeni Himalajan fsheh një sekret mjaft të errët. Liçeni Roopkund, i njohur si liçeni i skeletit ose liçeni i misterit, është një liçen akullnajor në Indi. Liçeni ndodhet afër fshatit Wan në rrethin Chamoli të Uttarakhanin, në Himalaje. Ai është mbuluar nga dëborat për rreth tetë muajt e vitit. Zbulimi i frikshëm i tij ishte bërë në vitin 1940, por misteri ishte zgjedhur në shekullin 21. Në vitin 1942, një roje pyjore britanike kishte gjetur rreth këtij liçeni plot kocka njerëzore! Ndërsa, në vitin 2004 ishte organizua një ekspeditë në



Roopkund me qëllim të qartë për të zgjidhur misterin. Ishte konstatuar se skeletet datonin rreth vitit 850 pas Krishtit. Kushtet e motit lokal bënë të mundur zbulimin e qimeve, mishit dhe madje edhe rrobave të viktimave, të ruajtura në gjendje të mirë.

FOTO E DITES



Luanët e uritur "shqyejnë" buallin në pak sekonda. Ngjarja ka ndodhur në parkun kombëtar Serengeti në Tanzani. /Nick Dale/

E jashtëzakonshme

E sulmon mbretëresha, prapanica i kthehet në fole bletësh

Një i ri 25-vjeçar është përballur me një fenomen të pazakontë, teksa ka zbuluar se në prapanicën e tij, mbi xhinse ishin lëshuar "një mal" me bletë. I riu nga India po udhëtonte drejt një garazhi kur mbretëresha e bletëve kishte

fluturuar mbi xhinset e tij dhe më pas të gjithë bletët e tjera pas duke bërë një koshere në prapanicën e tij. Pamjet e pazakonta janë filmuar, teksa i riu dhe miqtë e tij ishin në Nagaland, në veri-lindje të Indisë. Më pas një shok i tij



arrin të rrëmbejë mbretëreshën dhe ta fusë në një enë dhe pas sa fluturuan të gjitha bletët e tjera.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja, pas një grindje të ashpër me burrin:
- O Zot, të lutem merrem!
- Jo, jo, s'të merr, se ai s'është budalla si unë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30
The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30
ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Lëvizja e planetëve sot do t'ju sjellë të reja të këndshme dhe do t'ju japë mundësi për ndryshime të mira në financat tuaja.</p>	 <p>DEMI Një ditë e zhurmshme në planin e punës ku po vraponi për çdo gjë dhe për çdo detyrë. Mjaft të angazhuar ndërkohë me një surprizë që po përgatisni për partnerin.</p>	 <p>BINJAKËT Sot dita është e mbushur me ngjarje të mëdha e të vogla por që të gjitha mbartin një ndjenjë afektive kundrejt jush që do t'ju përkëdhelë.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk po arrini dot të menaxhoni personat e rinj në jetën tuaj. Në shumë raste do të keqkuptoni atë që do t'ju thonë dhe do të keni pakënaqësi.</p>	 <p>LUANI Megjithëse personat përreth jush ndiejnë shqetësime fizike këtë periudhë, falë regjimit tuaj ditor ju jeni në formë mjaft të mirë fizike.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Disa diskutime që kanë shumë kohe që janë hapur në familjen tuaj, më në fund do të arrijnë të finalizohen më së miri.</p>
 <p>PESHORJA Dëshira për tu socializuar sot ju sjell njohje të reja në çdo fushë të jetës. Disa prej tyre janë ato që po prisnit prej kohësh.</p>	 <p>AKREPI Do të keni mundësi të vizitoni një nga ato vende që ka qenë në dëshirat tuaja që herët. Gjithçka do t'ju duket më mirë seç e kishit menduar.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot do të shihni vetëm anën e mirë në çdo situatë dhe këtë gjë do të arrini ta përçoni edhe te të tjerët. Ditë e këndshme dhe me humor.</p>	 <p>BRICJAPI Disa çështje praktike që i kishit lënë pas dore sot do të arrini ti zgjidhni falë ndihmës që do t'ju japë një i njohuri juaj i vjetër.</p>	 <p>UJORI Do të keni fat në dashuri këtë periudhë falë pranisë së Venusit në shenjën tuaj. Nuk do ta kuptoni që në fillim këtë gjë.</p>	 <p>PESHQIT Duhet të filloni të rigjeneroni trupin dhe mendjen. E ku ka më mirë se ecje të gjata në ajër të pastër dhe kjo është pikërisht dita e duhur.</p>

Jennifer Lopez shkëlqen edhe kur shkon në palestër



Jennifer Lopez duket se ka dëshirë të shkëlqejë edhe kur djersitet. Këngëtarja 50-vjeçare ka ushtruar shumë dhe ka mbajtur një regjim shumë të ashpër ushqimor gjatë tërë vitit pasi ajo është në përgatitje për filmin e saj të ri "Hustlers" ku ajo luan rolin e një striptisteje që quhet Ramona. Dhe kur ajo ushtron fort në Miami bashkë me të fejuarin e saj, Alex Rodriguezin, duket se janë vetëm një palë tuta sportive që ajo preferon t'i mbathë: "Beyond Yoga Alloy

Ombre High Waisted Midi Legging" (110 dollarë). Lopez duket se i pëlqen aq shumë këto tuta sportive sa ajo i ka ato në tri ngjyra të ndryshme: të bardha, të zeza dhe ngjyrë rozë, të cilat i ka veshur shumë herë qysh nga muaji nëntor i vitit 2018. Tutat që shkëlqejnë, Lopez i kombinon gjithmonë me aksesore glamurozë, si syze shumë të mëdha, vathë të mëdhenj, atletet e markës "Adidas" dhe pa dyshim me çantat e ndryshme nga marka luksoze Hermes Birkin.

Izabel Goulart nxjerr në pah format e saj 'bombastike' në Itali



Një foto si në kohët e shkuara, në stilin klasik, por që nxjerr në pah të gjithë bukurinë e Izabel Goulart. Modeluesja dhe partnerja e portierit Kevin Trapp, i cili aktualisht luan për Eintracht

Frankfurt është duke kaluar një periudhë të shkurtër pushimesh në brigjet e Italisë, pikërisht në brigjet e Positanos, nga ku po mrekullon me fotot e saj të publikuara në rrjetet sociale.



Dua Lipa vazhdon festën e ditëlindjes me të dashurin në Malibu

Dua Lipa ka vazhduar festën e ditëlindjes me të dashurin në Malibu. Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Dua Lipa, dhe i dashuri i saj, Anwar Hadid, janë duke vazhduar festën e ditëlindjes së saj. Sipas "People"

çifti i njohur është për pushime në Malibu duke vazhduar festën e së enjtes ku Dua i bëri 24 vjet. Në një fotografi të publikuar në media shihet Lipa duke u puthur me të dashurin, ata duket se janë më të dashuruar se ndonjëherë më parë.

Kim Kardashian provokon në bikini

Kim Kardashian njihet për pozat e saj provokative. Mirëpo ani pse atë jemi mësuar ta shohim të tillë, sa herë që poston fotografi ku shfaqet provokative ajo merr vëmendjen. Njësoj edhe në atë të fundit në det ku shfaqet provokative në bikini derisa merr pozën që "çmendi" të gjithë. E ulur në rërë, Kim ka vënë në pah linjat e saj trupore.



Poeti që foli dhe flet si një zot

"Fije bari", libri me poezi i poetit të madh amerikan Uollt Uitman

Kam qenë në vitin e tretë të shkollës së mesme të kulturës në Tiranë, kur duke parë për kureshtje librat në pjesën joletrare të bibliotekës së shkollës gjeta vëllimin me poezi "Fije bari" të poetit të madh amerikan të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Uollt Uitman. Nuk e kisha dëgjuar më parë këtë emër, e hapa shkujdesshëm librin me vizatimin e një fijeje bari në kopertinën e zbërdhlytë, pa e ditur se pak minuta me vonë ajo që do të lexoja aty do të bënte masë me gjithë botëkuptimin dhe klishetë e mia letrare të asaj kohe, duke me përfshirë në një lloj deliri dhe krize plot vuajtje. "Qetësou, mos ki frikë! Jam Uollt Uitmani, gazplotë, zemergjerë si natyra..."

Po unë nuk qetësohesha. Më dukej se nuk lexoja, por në çdo varg që më kalonte para syve shtypja ca tasta që përfitonin një muzikë të rëndë, një të folur të epërme që me çonte peshë dhe më fuste frikën, pak a shumë si në ëndrrat e dikurshme me një zot që shfaqet midis reve apo qiellit për t'u drejtuar fjalën njerëzve në tokë. Unë mendoja se një vegim si ky, i ushqyer nga tregimet fantastike të gjyshes sime besimtare, kishte mbetur prapa bashkë me fëmijërinë e pakthyeshme dhe adoleshencën e parë, por ja ku më ishte kthyer më i qartë dhe më lëndor se më parë me zërin pa fytyrë të një poeti amerikan...

"Ju flas shteteve... teteteteteteteteteteteve", vibronte në bibliotekën e vogël kjo e folur prej zoti, që e dija të vdekur si të tillë. E mora librin pa i thënë njeriu, me lehtësinë që më kishte krijuar edhe mua shprehja e përhapur në atë kohë "vjedhja e një libri nuk quhet vjedhje", por edhe me një lehtësi tjetër të pacilësueshme, që më vonë e kam emërtuar një detyrim të vagëllt të koshiencës për t'i gjetur një vend tjetër ku të rrinte atij libri që ishte botuar në vitin 1957 kur unë nuk kisha lindur akoma dhe ishte shtyrë e shtyrë në periferi të bibliotekave publike të kohës ose ishte hedhur fare prej tyre si një "libër i padenjë" në shoqërinë e titujve të preferuar të rregjimit.

Mësuesja e letërsisë apo dikush tjetër nuk e kishin vendosur në raftin e librave që na jepeshin për lexim jashtë klase, por ishte e padrejtë që e kishin lenë mes

librave teknikë dhe politikë që nuk e di kush i lexonte. Një vend tjetër për "Fije bari" isha unë, shtëpia ime në Lezhë, shkallët e jashtme të asaj shtepie ku do të lexoja, më saktë do të "përleshsha" në sa e sa perendime dielli dhe muzgje te paharruara me Uollt Utmanin, duke habitur gjyshën time, së cilës, gjithsesi, nuk mund t'i thosha se e kisha gjetur zotin tim, pasi nuk mund të kishte një zot që të mos ishte edhe i saj.

Shumë vite më vonë do të lexoja nga poeti i madh argentinasi Jorge Luis Borges një koleksion të sentencave më të bukura e më të thella për autorin e "Fije bari", ku spikaste ajo se Uitmani nxorri nga përvojë e tij e fisme atë figurë të gjallë e vetjake që është njëra nga të paktat gjëra të leterisë moderne: VETË FIGURËN E TIJ.


Mund të duket e kërkuar sot, por është pikërisht ky përjetimi që kam patur në rininë time të hershme për vargjet e librit "Fije bari". Më dukej se ishte poeti që ngrihej prej poezive dhe jo e kundërta, pra nuk ishin poezitë që dilnin prej poetit. Thënë ndryshe, e shkruanin poezitë poetin dhe jo anasjelltas. Figura e poetit, mishëruar në vargje, ishte figura e dikujt që duhej të ishte, por nuk jetonte përnjimend në një pikë të planetit dhe në një fragment të caktuar të kohës së botës.

Çdo gjë që rrokte vështrimi i tij kishte fatin të mbushej me flakën, purpurin, limfën dhe përndritjen e poezisë. (Pashë në Luizianë një lis jetë duke u rritur/ qëndronte fillja vetëm, myshku i varej degëve/ pa shkop po rritej, nxirrte fletë plot gaz të mushkëlyera...).

Çdo gjë që dëgjonin vëshët e tij kalonte nepër frymëmarrjen dhe verbën e tij për t'u transformuar në këngë, në poezi. (Dëgjoj tek këndon Amerika, dëgjoj plot këngë të ndryshme/ këngën plot endje të nënës, të nuses apo të vajzës tek qep apo lan).

Çdo gjë që linte pas hapi i tij ngjallej dhe lëshonte tinguj si në mitin e Orfeut, ndërsa kur ndalej dhe mendonte për kohën, për gjithë atë përkujtim, e gjithë melankolia e tij burrërore shkrihej dhe humbiste në paanësinë dhe përjetësinë e së bukurës.

"Kur çeli jargavani vjet n'oborr te porta/ Dhe shoi ylli i mengjesit herët në qiell të perendimit/ Unë qava dhe do qaj çdo mot



kur vjen pranvera/ Çdo mot kur vjen ti pranverë më sjell tri gjëra mua/ jargavanin me lule, yllin e mengjesit që zbret në perëndim/ dhe kujtimin për atë që dua".

I kam mësuar permendësh që atëherë këto vargje dhe shumë të tjera nga Uitmani. Dhe nuk do t'i harroj më. Fillova të mësohesha me hapësirën e pamatë dhe tonin madhështor të poezisë së tij.

Vite më vonë kam mundur të kem një ide më të saktë për vendin dhe rëndësinë e jashtëzakonshme te librit "Fije bari" dhe të vetë Uitmanit në poezinë amerikane e botërore.

Përfshirë atë shqiptare. Disa emra të spikatur të gjeneratave poetike të viteve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë kanë dalë edhe nga fletët e librit "Fije bari". Qindra herë e kam lexuar si për herë të parë postulatit e Borgesit që ngulmon se nuk mund të ketë përbri poezisë së Uitmanit një biografi të Uitmanit pasi ky është personazhi i përjetshëm i poezisë që la. "Me kalie nga bota parajsores e vargjeve të tij në kronikën e pakripë të ditëve të tij, përbën një tranzicion melankolik", thotë Borges.

Nuk kam rreshtur pra së lexuari për Uitmanin, por kur mendoj

për emrin dhe pamjen e tij mitike prej profeti, kujtesa më kthen gjithnjë të një paradite pranvere e vitit 1996, sërish nxënës në shkollë të mesme të kulturës, tani në vitin e katërt. Në fund të oborrit të shkollës në lagjen "21 dhjetori" një grup nxënësish kishin rrethuar një burrë të gjallë rreth të shtatëdhjetave a më shumë, që po i pyeste për diçka. Nxënësit vetëm ngrinin supet duke qeshur me njëri-tjetrin dhe ja ku njëri prej tyre tregoi me gisht në drejtimin tim pak më tutje: "ai, ai lexon libra". Unë u afrova me kureshtje, me parandjenjen se duhej të jepja një "provim" të vogël para tyre. Shtatëdhjetëvjeçari me pyeti menjëherë:

-Ke dëgjuar ti për librin "Fije bari"?

Fytyra ime llamburiti. Mund të më kishte pyetur për dhjetra apo qindra tituj që nuk i kisha dëgjuar e lexuar ende deri në atë kohë, por ja që më kishte pyetur për "librin e vjedhur".

-Po, i thashë, e kam lexuar, është një vëllim poetik i shkrimtarit amerikan, Uollt Uitman.

Tani ishte fytyra e shtatëdhjetëvjeçarit ajo që u mbush me dritë. Nxënësit rreth e rrotull panë drejt nesh sikur po asistonin në një magji.

-Kush e ka përkthyer? - bëri pyetjen tjetër bashkëbiseduesi im.

-Skender Luarasi,- u përgjigja unë mes heshtjes së thellë të nxënësve.

-Unë jam Skender Luarasi, -ma ktheu tjetri me njëfarë mallëngjimi, duke më rrokur në qafë.

E fiksova fytyrën e tij, e takova edhe dy herë herë të tjera dy vite më vonë, kur endesha dyerve të Ministrisë së Arsimit për një të drejtë studimi në shkollë të lartë. Edhe atëherë, edhe tani kam një si hezitim të brëndshëm t'ja them emrin. Arsyja është kjo: qëkurse më tha se kush ishte në oborin e shkollës mendja ime e bashkoi me emrin e Uollt Uitmanit. Mund të ishte përkthyesi i madh dhe i pavdekshëm i Uitmanit në gjuhën shqipe një nga dyzimet dhe mishërimet e panumërta të këtij poeti universal në botë. Përkthimi prej tij i "Fije bari" në vitin 1957, sjellja në shqip i toneve dhe ritmeve madhështore të Uitmanit është një nga çuditë e jetës dhe historisë sonë letrare.

/mapo.al-Preç Zogaj/

Tregime nga Régis Jauffret

Doktor Mouton

– Ke harruar që je i papunë!
Diplomat tua qesharake nuk mund t'i habisin përjetësisht njerëzit e një vendi të shkatërruar, ku disa punëkërkuar, shkojnë deri aty sa t'i premtojnë para punëdhënësit që t'i marrë punë.

– Më ke kushtuar shumë shtrenjtë, që nga dita kur u martuam.

Mos të të shkojë mendja se do të të jap ndonjë lek për të gjetur punë. Përderisa s'di nga ta çosh kohën, do ta heq nga puna edhe shërbëtoren. Çdo mëngjes, para se të nisem për punë, do ta fliq apartamentin, e do t'i detyroj fëmijët t'i bëjnë nevojat e tyre herë këndeje e herë andej, veç që të mos kesh si t'ia bësh pa e larë krejt shtëpinë, përpara se ata të kthehen nga shkolla.

– Do ta gjesh një zgjidhje edhe për kolltuqet e mëndafshit, që nuk e durojnë as edhe një leckë të lagur.

Të dua, por mëshira është e kundërta e dashurisë. Do të ta bëj jetën aq të vështirë, thua se kam ndonjë urrejtje të thellë ndaj teje. Ke përfituar shumë gjatë nga jeta dhe pa asnjë dënim. S'kam qenë kurrë e sëmurë, asnjë aksident s'më ka ndodhur, madje kur lindja fëmijët, ti përfitoje të flije me infermieren.

– Kjo është e vërteta e pastër.

Thua se s'më mjaftonin dhimbjet e lindjes, por më duhej edhe të të vezhgoja me bisht të syrit. Rrije vërtet larg, por unë shihja qartë, përtej kafkës tënde, se si gjuaje rastin ta shihje infermieren të përkulur, për t'ja rrasur nga mbrapa në ëndrrat tua.

– Ti ëndërron në këmbë, si të gjithë perversët.

Por, tashmë lumturia jote po merr fund. Që nga java e ardhshme do të fillosh të ndjesh simptomat e para të infeksionit të mëlçisë, pasi mjeku ynë i devotshëm, Dr. Mouton, të ka injektuar virusin e hepatit, kur të bëri vaksinën kundër gripit. Je i lutur të më besosh, që sapo të shpërthejë verdhëza, do të bëj disa foto tuat me atë fytyrë limoni, duke pastruar apartamentin tonë të katandisur në një stallë lopësh.

– Fëmijët do t'i nxjerrin ato foto në profilet e tyre të Facebook-t. Tani eja të shtrihemi e të bëjmë dashuri. Bythët e mia s'kanë asgjë tërheqëse për ty, pasi ke dhjetë vjet që duhet të merresh me to, e karuci yt i përdredhur s'më ka dhënë kurrë kënaqësi, por dua që ti të zbresësh deri në kanalet e ujërave të zeza të jetës bashkëshortore, duke ia bërë gruas tënde.

– Kam vënë disa qeska, poshtë nënkrejsës.



Në fund të fundit ka shumë mundësi që edhe unë të vjell. Por do të vjellim pastër, drejt e në qeska, si të ishim në një avion. Të vjellat tona, do të t'i shpërndaj surratit tënd nesër në mëngjes. Do të zgjohesh i tronditur e do të kuptosh se sa larg mund të shkojë një grua, për t'ia nxirë jetën burrit të saj, për shkak të poshtimit që ndjen nga martesë me një burrë, të përjashtuar nga bota e punës.

Familje me qera

Mora me qera dy fëmijë të vegjël afrikanë dhe një grua turke. Pas disa vitesh, ajo deshi të kthehej në vendlindjen e saj për të krijuar një familje. – Familje me lidhje gjaku. Për t'u hakmarrë ndaj kurnacërisë sime, ajo mund të më akuzonte për përdhunim, kështu që për t'i dalë së keqes përpara i dhashë një sasi parash.

– Nuk m'i ke borxh këto para.

– Kështu ndjehem më i qetë.

Detyrimi për të ndarë të njëjtin shtrat që i shënuar në kontratë, por kishte një saktësim : çdo përpjekje për marrëdhënie seksuale nga ana e klientit, do të denoncohej e zgjidhej në gjykatë. Për t'i bërë ballë mungesës së kënaqësisë seksuale, më duhej të vizitoja vajza trotuaresh, ose t'i bija me dorë në banjo, pak para se të shtrihesha pranë saj.

Pas largimit të saj vendosa të shkoja tek zyra që ma kishte gjetur. S'kishin asnjë gjë më të mirë të propozonin se sa disa gra nga Subsaharaja, të rrënuara e të rrudhura.

– Është thatësira që i ka rrudhur.

– Jo, preferoj më tepër të

mbetem prind i vetëm.

Pa një nënë që t'i drejtonte, fëmijët u bënë shpejt të rrëmujshëm dhe e bënë lëmsh gjithë apartamentin. Kur kjo gjë o mor vesh nga agjencia që na e kishte dhënë me qera, na e mori menjëherë.

Tashmë jam beqar. Kam filluar të bëhem tapë, të paktën tri herë në javë, herë me shokë të punës e herë me miq të gjimnazit. Por nga që m'u dukën egoist, mendjemëdhenj, të gatshëm të talleshin, u largova shpejt prej tyre. Mora me qera një shok. Një djalë me inteligjencë pak më të ulët se e imja, por që të mund t'i kuptonte arsyetimet e mia bukur të vështira, por jo aq sa të kishte zotësi të m'i rrëronte ato. Desha që të ishte tërheqës, aq sa për t'i bërë vajzat e dehura t'i afroheshin tavolinës sonë. E zgjodhi një nga tufa e vajzave që po dilnin nga zyra, e hipnotizoi si të ishte gjarpër, e bëri të na ndiqte në restorant e po flet me të gjatë gjithë drekës, ndërsa unë i nxis të pinë sa më shumë, me qëllim që t'i deh. Pasi paguajmë, i jap çelësin e apartamentit tim, e bëj sikur zhdukem. Pas njëzet minutash, kthehem si hajdut, zhvishem në mesoren e errët e futem në dhomë. Ai largohet pak nga trupi i vajzës dhe unë zë vendin e tij drejt e mbi këmbët e hapura. Akti vazhdon sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Kur kënaqem, nuk e ndez dritën, as që shqiptoj ndonjë fjalë, nga frika se ajo mund ta marrë vesh se çfarë ka ndodhur. Pasi hedh rrobat e saj jashtë derës i jap udhët, si të ishte një fundërrinë. Kam marrë me qera shumë familje gjatë jetës sime, por pa qenë i lumtur asnjëherë. Do kisha dashur të martohesha me

dashuri e të kisha fëmijë. S'jam aq i hijshëm, kështu që kjo ëndërr ndoshta s'do të më realizohet kurrë. Nëse pas zhgënjimeve të mundshme profesionale, do të gjendem pas të gjashtëdhjetave pa ndonjë mundësi jetese, do të bie në pozitën e trishtueshme të jepem me qera si gjysh, të duroj talljet e fëmijëve e shpërthimet e dhunshme të të rriturve, të kënaqur t'i shfryjnë nervat mbi një të punësuar, krejtësisht të paafat për t'ua thyer turinjtë.

Një kafshatë mish

Më thotë të dua. I lutem ta qepë gojën. Ai vendos gishtin mbi buzët e tij. Një gjest që më bën të vjell, po aq sa fjalët e tij. Krahu i tij nis drejt meje pëllëmbën. I largohem, gishtat e tij përkëdhelin boshësinë. Më flet për anijen që do ta blejmë për t'u kënaqur kur të jemi në pension, duke u endur brigjeve të Atlantikut. Më flet për jetën tonë pas dhjetë vjetësh, njëzet, pse jo të mos përfundojmë në një nga ato arkivolet dyvendëshe e të varrosemi në varrezat e bukura në buzë të liqenit, ku gjenden tashmë nën dhe shumë nga bohemët, e pasuruar aq sa për të blerë një shtëpi të dytë buzë ujërave.

– Mos më thuaj kurrë më që më do ! Është përdhunim t'i thuash dikujt që s'të do më, të dua !

– Çfarë thua e dashur ?

Largohem nga dhoma plot zemërim. E dëgjoj duke qeshur në thellësi të këtij apartamenti të pafund, e mblidhem kruspull si një vajzuke që i trembet goditjeve. Ai endet, hapë dyer duke thirrur emrin tim. Po afrohet, do të më gjëjë në këtë fshehtë të apartamentit, ku kemi hedhur

valixhe, kartona dhe kapelet e një stërgjyshjeje, e cila ende mbi dhe në një epokë, kur akoma mbaheshin kapele të tilla. Ai lëshon një klithmë gëzimi, kur më sheh duke dalë prej aty e në korridor. I heq sandalet për t'ia mbathur më lehtë nëpër shkallë.

– A jeni mirë zonja Margo ?
Mbatha një palë këpucë në dalje pa ia hedhur sytë rojes së ndërtesës. Bie apo s'bie shi, është pranverë, dimër, pas pak nxehtësia e gushtit ta zien kokën si të ishte vezë . Eci shpejt, duke hedhur shikime në pasqyrat e veturave të parkuara përgjatë trotuarit, për t'u siguruar që s'mund të më kapë.

– Shkova drejt e tek shtëpia e një mikeje.

Ajo gati sa s'luan mendsh, kur më sheh duke hequr brekët në mes të sallonit të saj për të pshurrur mbi të gjitha të dua-t, me të cilat im shoq më ka rrasur dëng. Në fillim mikja ime më lakmonte se kisha një burrë aq të dashuruar pas meje. I propozova shoqes sime ta lëpinte pikën e fundit të shurrës, për ta provuar vetë, se sa e shpifur është të të dojë dikujt që ti nuk e do më.

– Dje shoqja ime s'ma hapi më derën.

Më fryu në fytyrë përmes vrimës së çelsit. Mora rrugën e kthimit, duke shtyre me brryla kalimtarët, u ngjita deri në apartament. Ai po më priste i ulur si papagall mbi komedinën e hyrjes.

– Mos më duaj, as unë s'të dua më !

Deshti të më puthte. Pranova veç që të mos e dëgjoja duke folur. Ia kafshova gjuhën, deri sa ia këputa. E përpiva si të qe një kafshatë mishi!

(mapo.al/Shqipëroi nga frëngjishtja : Arbër Ahmetaj)

Letra e shkrimtares Simone De Beauvoir për të dashurin amerikan

Parisi më duket i trishtë pa ty!

Janë rreth 600 letra dashurie që shkrimtarja franceze Simone De Beauvoir ia dërgoi të dashurit të saj amerikan, poetit Nelson Algren. Letra që përshkrojnë oqeanin për të treguar ndjesitë e një gruaje që është pushtuar nga dashuria. Nelson Algren është poeti i parë që fitoi çmimin e njohur letrar "National Book Award", për librin "Njeriu me krahë të artë". Përpara se të takohej me De Beauvoir, ai ishte i martuar me Amanda Kontowicz, me të cilën u divorcua dy herë. Historia me Simone do të linte gjurmë gjatë jetës së tij. Në vitin 1965, ai u takua me Betty Ann Jones, një pedagoge letërsie, me të cilën u divorcua dy vite më vonë. "Ai ishte një burrë fatal", do të shprehej Simone, teksa për vite të tëra e ruajti këtë histori si diçka të bukur, që era ia sillte nga larg, në kafenet e Parisit ku flitej për filizofi... E mbrëmjeve vonë kur ishte e trishtuar ajo hapte kutinë e letrave dhe lexonte jetën që një burrë i kishte dhënë dikur... "Nelson dashuria ime, të shkrova sot me një letër blu të shndritshme, ashtu si shpresa që ndrit në zemrën time që diçka e mirë do të ndodhë me ne... Ti do të presësh për mua në shtëpi dhe unë do të vij bashkë me një shishe shumë të mirë uiski për të pirë, pak proshutë për ta shoqëruar, për



të hequr lodhjen. Dua të më japësh shumë dashuri...aq sa nuk ndodhet në asnjë shishe uiski në Çikago...". Historia e dashurisë mes De Beauvoir dhe Algren do të bëhej publike vetëm pak kohë më parë, kur u publikuan disa foto nudo të shkrimtares, realizuar në vitin 1952 nga Art Shay, mik i Nelson. Shay 30 vjeç në atë

kohë, do ti realizonte disa foto De Bovuar teksa ishte duke u veshur në banjo.

Ja çfarë shkruan Shay për mënyrën sesi i realizoi këto foto: "Miku im Nelson Algren ishte i mërzhitur, pasi apartamenti që kishte marrë me qera për 10 dollarë në muaj nuk kishte banjo apo dush. Ai më kërkoi mua nëse kisha ndonjë vend ku mund të lahej madama. Ai më paralajmëroi me humor se ajo është "franceze" dhe nuk e mbyll derën e banjës...Unë i huazova banesën e një mikeshës sime...ku shkova bashkë me Nelson dhe Simonë. Si një fotograf i ri i Life Magazinë nuk mund të rrija indiferent ndaj një fotoje të tillë për De Beauvoir. Ndaj kur pash De Beauvoir kur doli nga banja me flokët e lagur para pasqyrës, bëra shpjegim disa shkrepje. "Ju jeni një djalë i keq", më tha ajo me humor, por pa mbyllur derën apo për të më kërkuar që ti merrte ato foto". Historia e tyre e dashurisë tashmë lexohet në librin "Dashuri trasatlantike, i cili së shpejti do të vijë edhe në gjuhën shqipe. Më poshtë një prej këtyre letrave të mrekullueshme që tregojnë çdo të thotë të jesh në dashuri.

*E enjte, 8 Janar, 1948
Nelsoni im,*

Ja ku ndodhem në Paris. Ishte një ditë mjaft poetike, siç ndodh ndonjëherë kur nuk e pret.

Gjithçka dukej sikur ishte kundër meje: nga qielli binte diçka që nuk ishte as shi, as dëborë, një ujë i zi dhe i akullt; një grevë e shitësve mbylli të gjitha dyqanet, kafenet dhe restorantet. Mund të kishte qenë tepër e trishtë, por fatmirësisht nuk qe e tillë. Së pari, gjeta letrën tënde të ëmbël dhe kjo më lumturoi. Fola me ty (në anglisht), gjithë ditën. Pastaj u kënaqa kur pashë sërish qytet. Qytetet më pëlqejnë. Ashtu i errët dhe i trishtë siç ishte, Parisi ishte qytet i vërtetë. Piva pak uiski (jo skoç, por burbo) nëpër bare, ku bisedova me miqtë. Shkova te revista Kohë Moderne, ku gjeta letrat dhe disa gjëra që më bënë të lumtur: përkthimi në anglisht i librit Gjaku i të Tjerëve, pra, do të mund ta lexosh në maj. Kam shumë dëshirë që të bëj një lidhje midis jetës sime si bretkosë në Wabansia dhe jetës në punë. Do të doja që të lexoje librat e mi, sidomos këtë, që është novela e dytë që kam shkruar dhe që jam e bindur se do të të tregojë diçka për mua. Dua që ta njohim njëri-tjetrin gjithnjë e më mirë. Prandaj u lumturova vërtet kur e gjeta, edhe pse përkthimi kishte gabime të tmerrshme. Do të botohet në maj, edhe në Londër, edhe në Nju Jork, prandaj për të do të diskutojmë në Meksikë. Po, meksikën nuk e ndaj nga mendja. Një shoqja ime që u kthye prej andej, më tha se Kuba ishte e mahnitshme. Po sikur pas Nju Orleansit të shkojmë në Kubë e pastaj në Meksikë? Tani, më kuj-

tohet sikur the që Karibet nuk të tërheqin, se druheshe që ishin vetëm për turistë? Mua do të më interesonte shumë dhe në Meksikë shkojmë një herë tjetër. Por mos u ngut! Mendoje njëherë! Gjëja e rëndësishme është të udhëtojmë dy muaj rresht: se ku, nuk është aq e rëndësishme, apo jo?

Po i kthehem së martës, mbrëmjen kur isha vetëm dhe dola shëtitje në Champs-Elysées për të parë Vilet e Zemërimin. U mërzhita kur dëgjova sërish zëra amerikanë dhe kur pashë vetëm rrugën që pata bërë me shoqen time nga Kalifornia në Arizona dhe në Nju Meksiko. Arrita t'i njihja vendet, sidomos urën në Kolorado. Disa plane në film m'u dukën mahnitëse: ato në fermën e keqe, kur policët vrasin ish-predikuesin. Kurrë nuk kisha parë një film kaq "të fortë", në kuptimin e mirë të fjalës. E djeshmja kaloi me gjëra të vogla, shumë çikërrima dhe duke fjetur gjumë. Ndihej disi e lodhur - mbase në fshat punova shumë. Sot po lexoj libra për gratë. Më intereson, por Parisi po fillon të duket i trishtë, ashtu si është vërtet dhe po kështu po ndihem edhe unë. Derdha ca pika loti, sepse të doja dhe më mori malli shumë. Fola me ty për një kohë të gjatë natën. Të dua, Simone.

Nga libri "Dashuri Transatlantike".
*Perkthyes Alda Bardhyli/
Copyright Gazeta Shqip*



Tregime nga "Një natë jetë" e autorit Flamur Topi

VDEKJA E PLAKUT

"O Zot! Pse s'më more më parë, por më le të gjallë të shoh këtë mënxyrë, këtë tmerr!"

Tregimi "Vdekja e Plakut", marrë nga libri me novela dhe tregime "Një natë jetë" e autorit Flamur Topi, përshkruan dramën e dhimbshme të të moshuarit invalid, që përjeton keq afrimin e dhunshëm të një shumëkatëshi, fare pranë ballkonit dhe dritareve të tij, duke i zënë përgjithnjë pamjet e dashura dhe të shtrenjta për të...

Plakut i kish pëlqyer gjithnjë vendndodhja e apartamentit të vet. Ai s'rreshte së përsërituri të tjerëve se nuk e ndërronte as me apartamentet modernë, një metër katror i të cilëve kush-tonte sa qimet e kokës... Jo vetëm për arsyen se banonte aty prej dyzet vjetësh e se që "mësuar"... Përpara pallati kish një lulishte dhe një kënd lojërash për fëmijë. Pastaj vinte rruga, më mirë të themi ana e këndejme e unazës, fill pas saj Lana, një lumë i qetë e paqësor, vazhdonte me anën e përtejme të unazës e fill pas trotuarit ngrihej ndërtesa e porsa mbaruar e Kishës Katolike; bri saj Banka Kombëtare Tregëtare, Shtëpia e quajtur e Oficerëve, gjelbërimi i dendur i lulishtes së Parlamentit e tej tutje kurora e lartë e Dajtit...

Plaku kish dhjetë vjet që ish paralizuar, lëvizte brenda për brenda apartamentit me një karrocë invalidësh dhe që i lidhur me pamjet që shtriheshin para pallatit më shumë se çdo banor tjetër i tij. Varësisht kohës, motit, të ftohtit apo të nxehtit, plakut qëndronte i mbërthyer orë të tëra pas xhamave të dritares ose në ballkon.

Askush s'mund të mburrej e të thoshte se më parë nga ai kish vënë re zënin e sytheve të drurëve, çeljen apo lulëzimin e tyre, zverdhjen e gjetheve e pastaj rënien e dhëmbshme të tyre (që plakut i shëmbëllente me vdekjen), lindjen e drurëve të rinj dhe plakjen e kalbjen e të vjetërve, mbirjen e barit të gjelbër e në fund të verës së thatë zverdhjen e tharjen e tij, shpërthimin aromëshumë të mimosave...

Pas xhamave ndiqte gati me ngazëllim pikat e para të shiut, në fillim të ngeshme e dembele, pastaj befaz shtrëngatën e frikshme, mbushjen kërcënuese gjer në grykë të Lanës e përmbytjen e unazës, kalimtarët apo makinat e bllokuara, deri-deri përveshjen gjer në gju të pantallonave e kalimin e mundimshëm për në trotuarin tjetër, ose ca më shumë, hipjen

në kurrizin e ndonjë të mjeri që për këtë shërbim të moçëm prej skllavi, sikurse kish dëgjuar, fitonte pesëqind deri në një mijë lekë të vjetër... E po atje, pas xhamave, ndërrimin si pa u ndjerë të stinëve... Dhe nëse ju rrëfejmë se plaku këtu e shtatëdhjetë vjet të shkuara, kish lindur në fshat e qe larguar prej tij që katërmëdhjetë vjeç e s'që kthyer më, (të kuptohemi, duke përjashtuar ec e jaket pesë-gjashtë ditëshe në raste sebesesh familjare) atëherë bëhet më e qartë lidhja e ngushtë dhe e pashqitshme e plakut me pamjet përballë, gjithherë të njëllojta në të njëjtën kohë gjithherë të ndryshueshme.

Por s'që e thënë që lumturia e plakut n'atë oaz të vogël, mes kioskash metalike të shpifura e pise, mbeturinash e plehrash të çdo lloji, të zgjaste!... Një mëngjes (të frikshëm për të) u shfaqën papritur, në mes të lulishtes, ballë për ballë me dritaren e tij, pesë a gjashtë burra. Njëri prej tyre mbante në dorë një stekë të lartë të graduar, një i dytë një goxha metër të gjatë që shkonte nga njëri skaj i lulishtes te tjetri, e ndërsa këta bënë punën e tyre, të tjerët tërë gjepte duarsh, mbi një hartë të madhe, (me siguri ndonjë projekt ndërtese) seç bisedonin tërë zjarr, nerv e pasion të kamurish...

- Mos! - thirri, (gati ulëriti së brendëshmi) plot dhimbje plakut. Mos! Më duket se ia kanë vënë synë e duan të bëjnë ndonjë shumëkatësh...

Plaku u hodhi një vështrim armiqësor të ardhurve. I urreu në çast.

U thirri nga larg, i pyeti se ç'donin, ç'kërkonin me ato vegla e mjete aty e përse po shkelnin për gjynah mbi bar e lulet e deles. Ata as që denjuan t'i jepnin një përgjigje, një fjalë të vetme të paktën, madje edhe kokën përtuan ta kthenin nga ai. Plaku ua përsëriti pyetjen dhe njëri syresh, me gishtin në buzë, si t'i drejtohej një fëmije, i dha të kuptojë se duhej të heshtte e të mos ndihej, se s'qenë punë për të.

- Na çmendën këta pleqtë! - iu duk t'u thoshte të tjerëve. Ngado vemi, do të mbijnë pesë a gjashtë prej këtyre matufëve! Ju duk apo e thanë vërtetë? Ja, zëre se e thanë...

- Matufër jeni vetë! Bile më keq! S'latë lulishte pa e zaptuar!... - u ulëriti aq fort sa gjeç, (mbase nga të thirrurit e sfocuar) një si cimbim të lehtë ndjeu në mes



të gjoksit dhe djersët e sikletit e mbuluan...

- Më duket se do të bëjnë një pallat tek lulishtja! - i tha të birrit, një burrë rreth të pesëdhjetave, sapo hyri brenda në shtëpi. Burri dukej i stresuar dhe i lodhur. Sapo kish mbyllur shërbimin 24 orësh në repartin e largët ushtarak.

- Prandaj më qenke ngrysur kaq shumë, thua se të janë mbytur gjemtitë?! Nëse e kanë ndarë mëndjen s'ka zot nëne t'i ndalë, dëgjovë baba?... Bën mirë të mos e marrësh me kaq alarm e leri gjërat të ecin si janë nisur... - S'ke faj ti, more bir, se je më shumë i dalë në punë të shtetit se në shtëpi, por për mua, një pallat në vend të lulishtes është vdekje, vdekje...

Pas xhamave (sikurse për dyzetvjet kish ndjekur nga afër ndërrimin e butë të stinëve), tani, me dhimbje të thellë në shpirt, tërë trishtim, mërzi e dëshpërim, teksa dridhej pa rreshtur prej një Parkinsoni të vjetër, shihte ngritjen e shpejtë të kateve të para. Por lartësimi në hapësirë i godinës s'që asgjë përballë tronditjes që i shkaktuan gërmimet e thella të ekskavatorëve gjigandë në lulishten e tij.

Egërsisht, pa mëshirë, dhëmbët e mëdhenj si të ndonjë përbindëshi, të makinës së rëndë nguleshin fort e thellë mbi drurë, shkurre, bar, lule, gurë, stola, rrethimin e hekurt... Plakut i bëhej se dëgjonte ohet e rënkimet e miqve të vjetër për shkak të plagëve të rënda që merrnin dhe zemra i shtrëngohej, i shtrëngohej, i bëhej si një grusht i mbledhur fëmije. Një çast, s'kish mundur ta mbajë veten dhe i ishin mbushur sytë.

- O Zot! - iu drejtua Perëndisë. Pse s'më more më parë, por më le të gjallë të shoh këtë mënxyrë,

këtë tmerr! Më mirë të më kishin vrarë mua, se sa këtë lulishte! O Zot, ç'po bëjnë, ç'po bëjnë!...

Dy katet e para të nëndheshëm mbërritën lartësinë e trotuarit e të rrugës. Deri në këtë nivel, plakut mund të shihte ende Lanën, rrugët, automjetet e njerëzit, që shkonin e vinin. Në mbarim të katit të dytë, plakut i humbi përgjithnjë nga sytë Lana e dashur, rrjedha e qetë e së cilës shpesh e nanuriste atje në ballkon e shlodhte dhe e vinte në gjumë si një foshnje...

Kati i tretë zuri gjysmën e Kishës dhe iu afrua frikshëm këmbëve të shtatores së Jezusit me të cilin përshëndetej çdo vakt. - Mirëmëngjes Jezus! Si u gdhive sot? A flete mirë këtë natë? Ah, unë?... Ç'ka! S'kam kam bërë shumë rehat... Mirëdita Jezus! Mirëmbrema Jezus!... Gjumë të ëmbël Jezus!...

- Shpejt po të vjen rratha ty, Jezus i dashur! S'kam për të të parë më! Kurrë më! Vetëm do të të përfytyroj pas këtyre betoneve të gurtë tek vezullon nga rrezet e para të diellit, tek të verbon me ndriçimin tënd qiellor të mesditës e tek më fshihesh ca e nga ca në muzg derisa s'të shoh më, ja si tani...

Kur mbaroi kati i katërt, plakut humbi nga shikimi Jezusin, por akoma jo këmbanoren dhe kryqin e lartë... Kati i pestë i zuri si një fasho e mermertë, e ftohtë, armike, e errët, e zymtë dhe e trishtë, gjithçka, gjithçka që mund të shihej përtej...

- Të paktën, të kishin bërë dritare këtej nga ana jonë, të paktën të shihja njerëz, njerëz të gjallë. Por tani, kam përballë vetëm një mal të thatë, një mal të ftohtë, të frikshëm, të zymtë e të pashpirt... Me mend, plakut mallkoi banorët e pallatit, që pasi s'kishin mundur të pengonin të panjohurit të ngrinin shumëkatëshin, kishin arritur të paktën t'i detyronin që në pesë katet e parë të

mos hapnin as edhe një dritare...

- Dhe ja tani, sikur të na kishin futur brenda një bunkerit të madh e të errët.

Përqark, asnjë qenie e gjallë e me shpirt. As pemë e drurë, as bar e lule, as mace dhe as qen, as edhe shpendë e zogj!... E çfarë mbin e lulëzon në gurë?...

Oh, ç'më bënë, ç'më bënë! Ma shkurtuan jetën, m'i nxinë këto pak vite e ndoshta muaj e ditë që më kanë mbetur...

Katet ngriheshin me shpejtësi marramendëse njëri mbi tjetrin e tani plakut mund të shihte akoma vetëm pak qiell e ndonjë yll të vetmuar. Pallati ngrihej dhe plakut, për shkak të një spondiloartroze të vjetër e të dhimbshme e kish gjithnjë e më të vështirë të ngrinte lart kokën për të parë atë pak copë qiell që i kish mbetur në hise dhe kjo po e bënte të vuante më shumë... Në katin e dymbëdhjetë, plakut humbi përgjithnjë edhe qiellin (ai s'mund ta ngrinte kokën më lart) dhe tani ditë e natë kish përballë vetëm betonin e ftohtë, të ashpër e armiqësor...

- Sa vjeç ishte? - pyeti mjeku i urgjencës tek plotësonte skedën e vdekjes.

- Shtatëdhjetë e pesë! - iu përgjigj shkurt i biri, me një dhimbje që i lexohej qartë në fytyrë.

Mjeku shkruante shkujdesur një diagnozë sa për të thënë, për të bërë ligjërish të pranueshme një vdekje, që për mendimin e tij anonte më shumë nga ajo natyrale, kurse i biri vështroi një çast plot dhimbje kufomën ende të ngrohtë.

Pastaj vështrimi i tij kapërceu dritaren, ballkonin e dashur të të atit dhe u përplas fort si një zogth i trembur dhe i çoroditur në shumëkatëshin...

- Një ditë do të shkoje, baba i dashur... E ç'jetë kish për të qenë paskësaj për ty?!... Gdhihu e ngrysu me malin e betonit në sy...

Vështrimi i mjegullt, gati armiqësor, kaploi shpejt njëri pas tjetrit të shtatëmbëdhjetë katet. Punohej në taracë. Katërkatëshi i tyre, një ndërtesë e viteve 60-të, dukej si e kërrusur dhimbshëm ndën peshën e gjigantit.

- Në pak muaj të thanë, të plakën e të vranë si t'im atë! - foli me trishtim tek e puthte lehtë, për herë të fundit, mbi ballin që kish nisur të ftohej dalëngadalë, ashtu si pamjet përballë, që tani, mbase për shkak të muzgut, dukeshin edhe ato si të pajeta.../mapo.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Shkëlqen Drita, Feronikeli njoftohet me humbje

Superliga e futbollit ka sjellë ndeshje shumë interesante edhe në javën e dytë. Feronikeli dhe Llapi janë njoftuar me humbje dhe forcën e vërtetë të Ballkanit dhe Drenicës, kurse Drita ka shijuar fitoren e parë sikurse edhe Gjilani. Pikët e para i mori Vushtrria në elitë, kurse Trepça '89 vazhdon të jetë në krye të elitës



fb.com/Ballkani1947 www.fcballkani.com

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 25 GUSHT - Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka harruar shpejt humbjen nga Ferizaj dhe sot e mposhti Flamurtarin (3-0). Në minutën e 4-t Betim Haxhimusa shënoi për 1-0. Pjesa e parë u mbyll me këtë rezultat, kurse në pjesën e dytë skuadra nga Gjilani ishte edhe më e mirë dhe si rezultat i kësaj shënoi edhe dy gola të tjerë.

Izair Emini (50') dhe Fidan Gërbeshi (79') nga penalltia realizuan golat. Kuqezinjtë nga kryeqyteti, pas barazimit në ndeshjen e parë ndaj Prishtinës, në këtë ndeshje nuk arritën t'i bëjnë ballë Dritës. Ndërsa Vushtrria ka shijuar pikën e parë në Superligë falë barazimit ndaj Trepçës '89 (1-1). Mitrovicasit kaluan të parët në epërsi me golin e shënuar nga Ardian Muja (17'), por vendasit barazuan nëpërmjet Jasmin Raboshtës (31'). Vushtrria pati rast të mirë të kalojë në epërsi në fund të pjesës së parë, por Daut Maxhuni dështoi nga penalltia. Ballkani i Ismet Munishit është treguar skuadër shumë e fortë për kampionin në fuqi, Feronikelin. Skuadra nga Suhareka e mposhti "Niklin" me rezultat 3-1 dhe në këtë mënyrë

tregoi potencialin që ka dhe se është një nga pretendentët për titull të kampionit në elitë. Blend Baftiu ishte lojtari i ndeshjes, pasi realizoi dy gola për vendasit, kurse një tjetër e shtoi nga penalltia Besnik Krasniqi. Golin e vetëm për mysafirët e shënoi transferimi i fundit, Haxhi Neziraj. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar të shtunën, Gjilani iu gëzua fitores së parë në këtë edicion garash, pasi e mposhti Ferizajn (3-0). Serinë e golave në fund të pjesës së parë e hapi Januzi, kurse në fillim të pjesës së dytë Progni e shtoi diferencën në 2-0, kurse për rezultatin final 3-0 është përkujdesur Busiq që realizoi në minutat shtesë të ndeshjes. Ndeshja në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit nga Klina është shtyrë për 25 shtator, pasi Federata e Futbollit të Kosovës dëshiron që të ruhet fusha në stadiumin "Fadil Vokrri" për ndeshjen kualifikuese në mes të Kosovës dhe Çekisë.

Besa e Liria e nisin me fitore

Skuadra e Besës së Pejës e ka nisur në mënyrë shumë të mirë kampionatin në Ligën e Parë, pasi e ka mposhtur skuadrën e Vllaznisë së Pozharanit (4-0). Në këtë mënyrë Besa konfir-

IPKO SUPERLIGA	
Drita - Flamurtari	3-0
Vushtrria - Trepça '89	1-1
Ferizaj - Gjilani	0-3
Ballkani - Feronikeli	3-1
Drenica - Llapi	3-0

TABELA	
1. Trepça '89	4 pikë
2. Ballkani	4
3. Drita	3
4. Feronikeli	3
5. Drenica	3
6. Llapi	3
7. Gjilani	3
8. Ferizaj	3
9. Prishtina	1
10. Dukagjini	1
11. Flamurtari	1
12. Vushtrria	1

Në xhiron e radhës takohen: Flamurtari-Ferizaj, Dukagjini-Drita, Feronikeli-Prishtina, Llapi-Ballkani, Trepça '89-Drenica, Gjilani-Vushtrria.

LIGA E PARË	
2 Korriku - Vitia	0-0
Onix - Vëllaznimi	2-1
Drenasi - Arbëria	4-0
Ulpiana - Istogu	1-2
Besa - Vllaznia	4-0
Trepça - Liria	1-2
Ramiz Sadiku - Dardana	1-2
Malisheva - KEK-u	0-0

TABELA	
1. Dardana	3 pikë
2. Drenasi	3
3. Istogu	3
4. Besa	3
5. Liria	3
6. Malisheva	1
7. KEK-u	1
8. 2 korriku	1
9. Vitia	1
10. Onix	1
11. Vëllaznimi	1
12. Ramiz Sadiku	0
13. Arbëria	0
14. Ulpiana	0
15. Vllaznia	0
16. Trepça	0

mon se do të jetë kandidatja kryesore për t'u rikthyer në Superligë. Klubi tjetër nga Rrafshi i Dukagjinit, Liria, që ka rënë në Ligën e Parë, arriti që në ndeshjen e parë të shënojë fitore në Mitrovicë ndaj Trepçës (1-2). Vëllaznimi pësoi humbje nga Onixi (2-1).

SHKURT

Xhaka: Humbja e dhimbshme, por duhet të qëndrojmë së bashku

Liverpooli e mposhti në derbi Arsenalin (3-1). Kapiteni i Arsenalit, Granit Xhaka, ka thënë se humbja është e dhimbshme, por duhet të qëndrojmë së bashku. "E dhimbshme është kur humbasim, por çelësi afatgjatë i suksesit është të qëndrojmë së bashku pas një dëshpërimi. Ne kemi nevojë për ju për sfidën e radhës, për këtë arsyeje ne jemi më të fortë", ka shkruar Xhaka.

Celina shënon edhe ndaj Birminghamit

Sulmuesi i Kosovës, Bersant Celina, ka realizuar gol sërish për Swansea. Ai ka shënuar edhe ndaj Birminghamit në xhiron e pestë të Championshipit. Celina shënoi golin e dytë, derisa Swansea fitoi me rezultat 3-0.

Sërish shënon Muriqi

Sulmuesi i reprezentacionit të Kosovës, Vedat Muriqi, po kalon nëpër një formë të mirë. Ai ka shënuar golin e dytë me fanellën e Fenerbahçes në sezonin e ri në Superligën turke. Muriqi shënoi në minutën e 77 ndaj Bashakshehirit, për ta barazuar rezultatin në 1-1. Sulmuesi shqiptar realizoi edhe në pjesën e parë, por goli ishte anuluar nga teknologjia VAR. Feneri e fitoi këtë ndeshje me rezultat 1-2.

Distria Krasniqi, e bronzë në Tokio

PRISHTINË, 25 GUSHT - Xhudistja nga Kosova, Distria Krasniqi, e ka fituar medaljen e bronzë në Kampionatin Botëror "Tokio 2019". Xhudistja pejana mposhti me ipon spanjollen Laura Martinez, kategoria -48 kg. Është kjo medalja e parë e Krasniqit në

kampionat botëror për seniore. Pas triumfit të Distrias në Tokio, trajneri Driton Kuka ka thënë se xhudistja pejana tregoi se si duhet të luftohet për Kosovën. "Medalja në Kampionat Botëror! Disi sot me performancën tënde tregove si

duhet vendi e si luftohet për Kosovën tonë. E bronzta e Disit ka shkëlqim që t'i merr sytë në Japoni. Kosova, mbi të gjitha, miq", ka shkruar Kuka në "Facebook". Sot (e hënë) lufton Majlinda Kelmendi, kurse nesër (e martë) Nora dhe Akil Gjakova.



Hila: Dua titullin me Prishtinën

PRISHTINË, 25 GUSHT - Mesfushori Ardit Hila është përforcimi më i ri i skuadrës së Prishtinës. 26-vjeçari nga Elbasani ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën e Prishtinës, kurse në edicionin 2018/19 është shpallur kampioni me Partizanin duke u

paraqitur në 27 ndeshje kampionale. Ai ka bërë me dije se e pranoi ofertën e Prishtinës me synim që të shpallet kampion i Kosovës në edicionin 2019/2020. "Është e vështirë ta ndërrosh Partizanin dhe me gjithë ofertat e tjera që nuk munguan, as nga skuadra pre-

tenduese, por projekti i Prishtinës, trajneri Josa dhe udhëheqja e klubit më bindën me planin dhe si përfundim vendosa t'i bashkohem Prishtinës. Të them të drejtën nuk është që di shumë për futbollin këtu, por vjen për të fituar, sidomos kampionatin,

me të cilën pa mburrje them se tani e kam një përvojë të tillë të fundit me Partizanin, dhe besoj se do ta ndihmoj shumë ekipin drejt këtij rrugëtimi, e që Prishtinës i mungon", ka thënë Hila për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas të Kosovës.



Kosova la gjurmë në Evropian

PRISHTINË, 25 GUSHT - Kosova U16 ka përfunduar në vendin e 20 në Kampionatin Evropian Divizioni B në Sofje të Bullgarisë. Vashat e Kosovës në luftë për vendin e 19 kanë pësuar nga Austria me rezultat 34:45, duke përfunduar kështu në pozitën e 20 nga 23 shtete. Kosova e nisi ndeshjen mirë dhe çerekun e parë e fitoi 17:6, por dy periodat e ardhshme i humbi 6:17 dhe 2:14, kurse periudha e fundit ishte formale, edhe pse Kosova e fitoi 9:8.

Fjolla Ajeti realizoi 15 pikë, derisa nga shtatë shënuan Diçe Daku dhe Enisa Kamerolli. Sidoqoftë, kjo ishte një përvojë e mirë për vashat e Kosovës që në të ardhmen pritet të bartin barrën kryesore për Kosovën. Njëkohësisht, kjo ishte edhe ndeshja e fundit për gjeneratat e reja të Kosovës, ku në këtë verë 6 përfaqësues morën pjesë në Kampionatet Evropiane, të gjitha në Divizionin B. Basketbollistet e Kosovës lanë gjurmë në Evropian. Astera Tuhina ishte



e 18-ta nga 276 lojtare, me mesatare prej 12.1 pikëve për ndeshje. Fatkeqësisht, ndeshja e fundit ndikoi që mesatarja e saj të ulet, pasi deri para kësaj ndeshje ajo ishte në pozitën e 11-të. Enisa Kamerolli u rendit në vendin e 25-të me 11.3 pikë për ndeshje, kurse pas

saj ishte Fjolla Ajeti me një mesatare prej 11.2 pikësh për ndeshje. Sa iu përket kërcimeve, Astera Tuhina dhe Anita Grainca kishin nga tetë për ndeshje, duke u renditur në vendin e 23-të. Edhe tek asistimet, Astera u rendit e 18-ta me tri asistime për ndeshje.

Rinsi ia rrëmben fitoren Marquezit

NORTHAMPTON, 25 GUSHT - Kthesa e fundit po kthehet në një makth për pilotin spanjoll Marc Marquez, që nuk po arrin të fitojë më. Pasi humbi dy javë më parë garën e Austrisë në kthesën e fundit (triumfoi Dovizioso), këtë herë Marquez humbet garën e Silverstone (Angli), po me të njëjtin skenar. Në kthesën e fundit ai u parakalua nga Alex Rins me Suzuki, që fitoi me "fotonish" ndaj Marquezit me Honda, i dyti, në fund të një dueli "rrotë me rrotë" mes dy pilotëve. Ata dueluan fort nga xhiroja e parë deri tek e fundit, duke dhuruar spektakël në pistë. I treti u rendit Maverick Vinales me Yamaha. Pra, tre spanjollë në podium. Gara e botërorit e Moto GP e zhvilluar në Silverstone ishte mjaft e bukur, me Rins dhe Marquez që garuan të shkëputur nga të tjerët. Emocione që në fillim, ku Quartararo rrëzohet dhe i pret rrugën Andrea Dovizioso, që gjithashtu del jashtë pistës. Italiani i Ducatit përfundon në qendrën



shëndetësore për një kontroll. Gara vazhdon me dy të parët që bëjnë një garë më vete, teksa shpejt dorëzohet Valentino Rossi, që u rendit i katërti. Ai u parakalua edhe nga shoku i skuadrës, Vinales, duke mos qenë asnjëherë pretendent për fitoren në pistë. Në xhirot e fundit Marquezit dhe Rinsi dhurojnë spektakël në pistë, por ashtu si dy javë më parë në Austri, fituesi përcaktohet në kthesën e

fundit. Rins hyn nga pjesa e brendshme e pistës dhe triumfon, duke befasuar Marquezin, që nuk e priste të humbiste sërish në të njëjtën mënyrë. Pavarësisht prej vendit të dytë, Marquezit konsolidon pozitën në krye të renditjes së Moto Gp, duke parë që Dovizioso nuk mori asnjë pikë. Gara e radhës së botërorit pas 3 javësh (15 shtator) në San Marino (pista e Misano).

SHKURT

Tottenhami cakton çmimin e Eriksenit

Tottenham Hotspur ka vendosur tashmë një çmim për ta shitur mesfushorin Christian Eriksen përpara afatit të 2 shtatorit. Sipas mediumit britanik "Daily Mail", Tottenhami është gati ta shesë mesfushorin për 50 milionë funte. Juventusit, Real Madridit dhe Atletico Madridit janë skuadrat që po interesohen për Eriksenin.

Lewandowski konfirmon se do ta vazhdojë kontratën me Bayernin

Robert Lewandowski shkëlqeu në fitoren e Bayern Munchenit ndaj Schalkes (0-3), duke shënuar tre golat për kampionët e Gjermanisë. "Unë gjithmonë mund të luaj më mirë dhe kam potencial të përmirësohem çdo sezon. Mund të bëj diçka të veçantë në çdo sezon, por përpiqem ta ndihmoj ekipin. Pavarësisht se me kë luaj kundër, gjithmonë përpiqem të shënoj gola", ka thënë Lewandowski, i cili bëri me dije se është afër vazhdimit të kontratës edhe për dy vjet. "Jo akoma, mbase 95 për qind", ka shtuar sulmuesi polak.

Zaha, zëvendësues i Neymarit

Edhe pak ditë përfundon afati kalimtar, por e ardhmja e Neymarit vazhdon të mbetet e paqartë. PSG-ja po mendon për zëvendësimin e brazilianit i cili mund ta transferohet në Real Madrid ose Barcelonë. Bëhet fjalë për Wilfried Zahan e Crystal Palaces. Skuadra angleze kërkon 109 milionë euro për 26-vjeçarin, shumë e cila nuk do të jetë problem për PSG-në.

Rikthim emocionues i Jamesit në Real

Ndonëse ishte i padëshiruar nga trajneri Zinedine Zidane, James Rodriguez nuk është shitur nga Real Madridi dhe të shtunën ishte në fushë nga minuta e parë në sfidën që madrilënët zhvilluan përballë Valladolidit. Kjo ishte ndeshja e parë pas dy vjetësh për kolumbianin që u largua nga Reali në verën e 2017-s, në një huazim dyvjeçar te gjermanët e Bayern Munchenit, ndërsa tani është i bindur për qëndrimin në kryeqytetin spanjoll. "Pas shumë kohësh jam kthyer në 'Bernabeu' dhe ishte një emocion unik. Falënderoj tifozët për mbështetjen. Vazhdojmë punën për t'u përmirësuar", ka shkruar Jamesi, duke mbyllur përfundimisht mundësinë e largimit nga Madridi.

Kovalevi e mbron titullin e botës në WBO


Sergey Kovalev i ka mbijetuar një trembjeje në raundin e tetë dhe e ka nokautuar britanikun Anthony Yarde për ta mbrojtur titullin WBO në kategorinë e lehtë në një meç dërrmues. Rusi Kovalev dominoi në fillim, i cili në qytetin e lindjes së tij Chelyabinsk, por gati sa nuk u mposht në raundin e tetë kur u gjend nën sulm të pandërprerë nga britaniku. Yarde ishte buzë lavdisë, por kampionet e dinë se si të dalin nga situatat e vështira. Edhe pse i dërrmuar, Kovalev u kundërpërgjigj shumë mirë dhe e nokautoi Yarden në rundin e 11-të. Kështu, rusi e mbrojt titullin e botës në kategorinë WBO. Për britanikun kjo ishte mundësia e parë për të luftuar për titullin e botës.

De Ligt: Prisja të isha titullar

Matthijs De Ligt është një nga blerjet më të shtrenjta në historinë e klubit të Juventusit, por ai qëndroi në stol në ndeshjen që kampionët e Serisë A e luajtën ndaj Parmas. "Nuk e prisja që ta

nisja kampionatin nga stoli. Preferoja që të luaja titullar. Gjithsesi, e respektoj vendimin e trajnerit. Duhet të jem realist, jam ende duke u ambientuar me skuadrën. Chiellini dhe

Bonucci për shumë vite janë konsideruar si dyshja mbrojtëse më e mirë në botë. Këtë sezon duhet të luftoj shumë për të siguruar një vend si titullar", ka thënë De Ligt.

	Autor: GAZMEND MORINA	IRNOSET (bised.)	CIGAN ENDACAK, ARIXHI	FABRIKAT E MEKANIZU-ARA	KRAHINË NË SHQIPËRI	SKUADËR	LLOJ VETURE JAPONEZE	EPOKA E RE	STADIUM I MADH NË BRAZIL	EMPOLI, GROSETO	NOTË MUZIKORE	BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (shq.)
	KRYETAR I NJË MANASTIRI TË MURGJVE ORTODOKSË							FUTBOLLISTI LIONEL				
	RRUSH KO-KËRRGJATË, I KUQ A I ZI DHE ME CIPË TË TRASHË								NIS TË ZBARDHË DITA BEKIMI			
	E MBARUAR, E PËRFUNDUAR									DY BASHKË-TINGËLLORE DREJTIM		
	NGJYRË E FYTYRËS					PRIMITIV AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.)						INTER LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË
EPOKA E RE	LOCAL AREA NETWORK AKTORJA JONË IRENA					SMIRË KRIJIM, GJË E SHPIKUR NGA MENDJA						RITUALET
BASHKËT.					GOTË PREJ BAKRI KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE			HEROI MEHA FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART				
ALYSSA MILANO					PJESË E EPËRME E DHOMËS SHARRËZ					GABRIEL IGLESIAS FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER		
EPOKA E RE	PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE	FAZA	KËNGËTARJA ZYMERI	ISH ATLETJA E SHQUAR MERLIN	NORA ISTREFI	FATKEQËSI E MADHE, KOB (shq.)			NITROGJEN ZAKON			
QENIE MBINJ-ERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË (mit.)						KËNGËTARJA NË FOTO TAHIRI				NËNË (turq.) ISMET TOTO		
PARA TË NËNTIT						VLERËSIM ME NOTË SHTET I MADH NË AMERIKËN VERIORE		LETRARI MEHMETI NGATËRRESA E MADHE			TREVISO BËRJE MË I RI	
SHEGA					SHTET I MADH NË AZI KUNDREJT BASHKËTIN-GËLLORE		PA U NXITUAR, NGADALË (turq.)	I SHËMTUAR (bised.) HARK, KTHESE				BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA
VËLLAI I MADH				ZENEL AHMETI VIJË E PËRKULUR SI LAK (gjeom.)		JETËSHKR-IMET BABAI				"... TAK" DASH QË E KA TURIRIN TË BARDHË E ME PIKLA SI TË KUQE		
MARK ANTONI			LUMË NË SHQIPËRI KËNGËTARI SHAQIRI (shq.)			VEZAK			BALTË E QULLËT, GJANË (shq.) TROPOJA			
ZANORE		FLEGËR EMËR MASHKULLI TURK (shq.)				I GJYMTI DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË					"IZMIR" KOPJIMET	
RRËSHQANOR I MADH (zool.)						BASHKËT. RRËMUJË		JEMENI DY BASHKË-TINGËLLORE		HUMORIST I YNI MUAJ I VITIT		
BEND I YNI MUZIKOR						ALI ASLLANI RAST		BANJË ALLATURKA ENDE				MOLDE QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI
EPOKA E RE	GËZIM I MADH QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP					ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ LILIAN VISHET ME BAR				KËNGËTARJA TAKE AGJENCIONI EVROPIAN		
BANORE E LABËRISË					PRESIDENTI AMERIKAN OBAMA KËNGËTARE E NJOHUR Ë SHQIPËRI			ADEM JASHARI RAMADAN AVDIU				HISTORIANI ROMAK LUKRECI ARKË SHUMË E VOGËL PREJ DRURI
KYÇI				PRINCIPIELE DJALI KUNDREJT PRINDËRVE (pashq.)						LLOJ PEME TROPIKALE (pashq.) TENISTJA CLIJSTERS		SHTEG
RIFAT ISMAJLI			ELEMENT KIMIK BELGJIKA, AUSTRIA				NËNË "MESINA"		BIXHOZ RENS ISTVUD			
ZANORE		DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME LECCE				RESHAT ARBANA TRIERI		KALORËS MESJETAR BASHKËT.				
VEGËL MUZIKORE								KUFIZIM				



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/ MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/ MINISTRY OF HEALTH

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale – AKPPM/ Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva – KALMS/Kosovo Medicines Agency – KMA

Njoftim për Zgjatje të Afatit për Aplikim në Konkurset në AKPPM

Ju njoftojmë se zgjatet afati për aplikim në konkurset në AKPPM edhe për shtatë (7) ditë kalendarike, nga data 26.08.2019, për pozitat :

Zyrtar/e i Lartë për të Hyra dhe Shpenzime

Zyrtar/e i Lartë për Buxhet dhe Financa

Zyrtar Ligjor 2

Zyrtar/e për Logjistikë

Zyrtar/e i Lartë për Narkotikë

Zyrtar/e i Lartë në Divizionin për Menaxhimin e rrezikut

Asistent/e Ekzekutiv/e në Zyren e Drejtorit të Përgjithshëm

Zyrtar/e i Lartë për Autorizim Marketing

Dy (2) Zyrtar/e për Kontrollimin e Dokumentacionit të Autorizim Marketingut

Dy (2) Zyrtar/e të Lartë të Sigurimit të Cilësisë

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Albana Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat ,diplomën dhe certifikatën e gjimnazit Gjon Buzuku Prizren.
- ▶ Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 Euro kontakti 044-171328.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Shpall konkurs për pranimin e fëmijëve të moshave të ndryshme (0,9 - 6 vjeç)

Aplikimi për regjistrim të fëmijëve fillon nga data:
10.08.2019 deri 30.08.2019

Për çdo informatë shtesë mund të drejtoheni përmes telefonit 045 714 713.

